39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes

së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40

Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41

Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi;

b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [gjuha e procedurës - shqipe].
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës: 33.691.72 €

Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	10.2	Ofruesi i Punëve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin Kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i Punëve, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij. Ofruesi i Punëve do të jetë tërësisht përgjegjës për dëmet eventuale në pronën,. Çdo dëmtim i shkaktuar do të korrigjohet nga ofruesi i Punëve në shpenzime të veta. Ofruesi i Punëve duhet të sigurojë që i gjithë stafi i tij, i cili kryen shërbimet, janë të siguruar plotësisht dhe kane përgjegjësinë për ndonjë dëm nga ta.
	10.3	Kontraktori është përgjegjës për aplikimin e ligjeve për mbrojtje në punë të punëtorëve të tij përveç tjerash edhe duke : - bërë sigurimin e zonave të punës për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt - duke u siguruar në gatishmërinë profesionale të punëtorëve, - duke u siguruar në përdorimin e drejt të veglave dhe mjeteve adekuate dhe funksionale nga punëtorët, - duke obliguar punëtorët që të mbajnë uniformat e kompanisë (uniforma duhet identifikuar kompaninë) si dhe rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë si : rrobe pune, helmeta, këpucë adekuate varësisht nga natyra e punës dhe stina, syza mbrojtëse, dorëza pune ...etj. varësisht nga natyra e punës të angazhoj punëtorë me kualifikime adekuate, njohuri dhe përvojë të duhur për kryerjen e punëve të nevojshme
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat];</i> (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat];</i> (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat];</i> (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i> Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të

		Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë,dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Zyrtarin e prokurimit nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Kontraktuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre
Programi	12.1	Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës konform Nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës dhe ta dorzojnë në zyren e prokurimit Kryetari i komunës , Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Njësia kërkuese dhe komisionin për pranim teknik me një Vendim tjetër . Të dy palët obligohen të mbajnë ditarin e punës dhe nga një kopje të dorëzohen në arkivin e dosjes për pagesë.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar sipas planit dinamik. Pagesat kryhen ashtu si raporton Organi mbikqyrës, pagesa e fundit kryhet vetëm pasi të ofrohet Garancioni për kualitetin e punimev{për eliminim e të metave} në shumën prej 10 % të vlerës së ofertës
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë Data e fillimit do të jetë 3 – 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Punëkryerësi duhet ta ketë në vendpunishte çdo herë Inxhinierin e prezentuar në dosje të tenderit. Nëse pas urdhërit prej tre ditëve nuk paraqitet Ixhinieri i OE në vend punishte, Komuna ka te drejten t'i jap urdhresen e fundit per nderprerje te kontratës.Poashtu njëjtë vepron edhe kur nuk i angazhon paisjet me te domosdoshme ne vendpunishte/
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [730] ditë. <i>Nga fillimi i punimeve</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë Nëse Ofruesi i punëve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë,Autoriteti kontraktues,pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij

		sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së punëve të pa kryera deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të porosisë.. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim dhe do të jetë përgjegjës për mos futje në penale.
Regjistri i punës	20.1	20.1 Një regjistër i punës do të, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm: a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit; b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit. 20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të

		marr një kopjetë shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij. 20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Autoriteti Kontraktues do të emëroj <i>“Menaxherin e Projektit”</i>, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues. ▪ Inspektimin dhe testimin e materialeve e kryen Organi mbikqyrës sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testetimet e para i kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Organi mbikqyrës nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues. -Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord. -Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>Parapagim nuk do të ketë</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>10% e vlerës së kontratës do jet sigurim bankar për garantin e punimeve</i>
Shkaqet për kompensim	30.	Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim: (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë. (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt. (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin. (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në

		lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës. Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit
Konfiskimi i sigurimit të ekzekutimit	30.5	30.6AK do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në situatat e mëposhtme: a) Në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila shkakton dëme materiale për AK dhe/ose kërkon që AK të shkaktoj shpenzime të konsiderueshme në përfundimin e kontratës së tillë; ose b) Për shkelje të kontratës së nënshkruar shumë punëtorë, nën-kontraktues dhe/ose furnizues kanë mbetur të pa-paguar. 30.7 AK para se të filloj procedurën e konfiskimit të sigurimit të ekzekutimit AK duhet të informoj, me shkrim, OE për çdo dështim të supozuar me kontratë dhe të jep OE kohë të mjaftueshme për korrigjim të dështimeve të tilla. Dështimi i OE për të korrigjuar, në kohë, dështime të tilla të supozuara do të rezultojë në procedurën e konfiskimi. 30.8 Konfiskimi i sigurisë së ekzekutimit, nuk e ndalon autoritetin kontraktues të kërkojë zhdëmtimin shtesë që rrjedhin nga kontrata dhe, po ashtu, nëse siguria e ekzekutimit është me vlerë më të lartë se dëmet nga shkelja, autoriteti kontraktues duhet t'i rik-thejë diferencën. 30.9 Autoritetet kontraktuese nuk do të kufizojnë në dokumentet e tenderit diskrecionin e tenderuesve që të paraqesin sigurimin e performances në cilëndo nga format e përcaktuara në nenin 30.5 të këtyre rregullave dhe Udhëzuesi Operativ. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen përveç atyre të referuara në nenin 30.5, do të konsiderohet e pavlefshme. Pavarësisht nga neni 63 i LPP-së, sigurimi i ekzekutimit duhet të jetë i pakushtëzuar. Për qëllimet e mësipërme, fjala "pakushtëzuar" do të thotë një garanci e zbatueshme me kërkesë dhe se nuk duhet të ketë ndonjë kusht ose kërkesë për ndonjë dëshmi të përfshirë në sigurimin e ekzekutimit përveç një kërkesë që Autoriteti Kontraktues duhet të ofroj një dokument që tregon që ka ndodhur shkelje gjatë implementimit të kontratës. Si rrjedhojë nuk

		ka nevojë të mëtejshme që autoriteti kontraktues të vërtetoj shkeljen Në mbështetje të nenit 63, paragrafi 5, të LPP, kërkesat për kualifikimin e lëshuesve të sigurimit të ekzekutimit, siç është përcaktuar në dosjen e tenderit, do të jenë jo-diskriminuese, nuk do të kërkojnë nga lëshuesi që të ketë një biznes në një vend të veçantë, dhe në çdo rast do të kufizohet vetëm në kriteret që janë të lidhura drejtpërdrejt me sigurimin e stabilitetit financiar dhe besueshmërinë e këtyre institucioneve
Mbikëqyrja	32.1	Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasësave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Punët shtesë	32.2	Nëse paraqitet nevoja: Do të ecet me procedurë për punë shtesë nëse paraprakisht merret autorizimi nga Mbikqyrësi dhe ZKA-ja.
Pagesat	32.3	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.
Dorëzimi i dokumentave	32.4	Zyrtari për pagesë para se t'i kryej pagesat duhet të bindet se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës, aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera, faturat, atestet për materialet e përdorura nëse ka, shkresat, fletët e ditarit të punës, arsyetimin për tejkalimin e ditëve kalendrike nëse ka, sigurimet, etj, në të kundërtën e marrë përgjegjësinë.
Arkimi i dokumentave	32.5	Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimi, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimi dhe kontratës pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen tek Zyrtari për rexhistrimin e pasurisë.
Hyrja në fuqi	33.6	Kontrata hynë në fuqi 3-5 ditë pas nënshkrimit të palëve ose si ditë zyrtare do të konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher për fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe --- -Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve dhe një kopje të dorëzohet në zyren e prokurimit. Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të

		kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plani i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Informatë shtesë	33.7	Kontraktuesi e ka për obligim ta vendos PANON në hyrje dhe dalje te punishtes në madhësinë standarde, ku do të përfshihen, titulli i projektit, investuesit dhe punëkryerësi.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 1095 ditë ose 3 vite Po ashtu për sigurimin e cilësisë së punëve, Operatori Ekonomik pas pranimit teknik duhet të ofrojë garancion bankar për sigurimin e punëve 10 % nga vlera e kontratës, në kohëzgjatje 3 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do ti sanojë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën pajtohet se AK ato dëme do ti sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do ti faturojë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Nese jane grup OE,kjo deklarate epet në emër të liderit të konzorciumit
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Të gjitha mosmarrëveshjet do të tentohet që të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Projekt menaxheri i kontratës, personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues, Zyrtarin përgjegjës të prokurimit si dhe personave përgjegjës të autorizuar nga Kryersi i

		punimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës

ANeks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Hartimi i Projektit Kryesor

Per bazë për hartimin e projektit kryesor për rrugën “**Plemetin-Hamidi**” janë marrë:
rregullativat teknike dhe standardet ekzistuese.

Rregulloret teknike gjermane për projektimin e rrugëve RStO

Qarkullimi i mundshëm i madhe i automjeteve

Shpejtësia llogaritëse sipas detyrës projektuese $vq=60\text{km/h}$.

Projekti është porositur që të punohet nga KK Obiliq.

1.3 PËRSHKRIMI I PROJEKTIMIT

Rruga “**Plemetin-Hamidi**” është një rrugë e projektuar duke u bazuar në rrugën ekzistuese. Gjatesia e rruges është $L=865.65\text{m}$

Elementet kryesore teknike të projektuar janë si në vijim:

$R_{min} 25$ $R_{min\text{ conv}} 100$, $R_{min\text{ cōmc}} 67$

$L_{min} 25$

$S_{max} 3\%$

Elemente të tjera të cilat bazohen nga shpejtësia e kufizuar $V=60\text{ km/h}$, dhe kategori e IV – të rruges.

Elementet kryesore të cilat janë marrë për baze në formimin e situacionit të përgjithshëm janë :

- Rruga kryesore në dy drejtime 1 x 2 shirita

2 shirita2x2.50 m

bankina2x1.5 m

1.3.1 Zgjidhja niveletes për rrugën

Niveleta e rruges është e projektuar në përputhje dhe në harmoni me rrugën ekzistuese. Janë marrë për baze edhe kyqjet anësore të rruges.

Ramja gjatësore e rruges është $S_{min} 0.3\%$ dhe $S_{max} 3\%$ (duke marrë parasysh terrenin dhe trasen e rruges me ramje tërthore 2.5% . Bankinat janë me ramje tërthore 4% .

Llogaritja e dhe dimensionimi i shtresave të rruges

Fillimisht duhet të ceketë se për dimensionimin e shtresave të trupit të rruges nga ana e investitorit në detyrë projektuese përveq kategorisë së rruges dhe kërkesës për dimensionim për ngarkesa të mesme nuk janë dhënë edhe disa elemente të nevojshme për dimensionimin e shtresave si p.sh numri i automjeteve që kalojnë për një vit, numri i automjeteve të renda po ashtu për një vit, temperaturat mesatare vjetore si dhe ato ekstreme, etj. Në mungesë të këtyre parametra të njëjtit do të supozohen në mënyrë që sa më shumë të i përshtaten kushteve dhe parametrave real. 3

Kushtet lokale

Pasi qe nuk jane dhene te dhena per temperaturat minimale nga njohuria e rajonit mund te supozohet se ngricat mund te depertojne ne thellesi prej 70 cm deri 90 cm
Per dimensionim do te merret perudha kohore prej 15 viteve, edhe pse deri ne kete kohe asfalti ekzistues mund te pesoj deformime te medha dhe si i till do te kete nevoje qe te rishtrohet me nje shtrese te re te asfaltit.

Pasi qe nuk eshte dhene numri i automjeteve ne dite dhe lloji i tyre supzohet se ne dite do te kalojne rreth 100 kamion ne dite (vlere pak me optimiste) me ngarkesë mesatare deri ne 10 ton per aks per te cilen ngarkse ekuivalente per kete tip eshte 0.561) Numri fillestar i automjeteve	Vlera mesatare per periudhen 15 vite	Vlera mesatare aksiale vjetore 10 t	Numri i kalimeve te ngarkesave ekuivalente 10 t
100	134	75	.29*106

Ne baze te ketyre vlerave dhe vleres mesatare te CBR prej 5% per kete tip te shtreses dimensionimi do te behet sipasa disa metodave duke u bazuar ne vleren mesatare te indeksit ta aftesise mbajttese "i"

Dimensionimi do te behet sipas disa metodave:

DIN (Metoda e thjeshte)

Per CBR 4% dhe $T=0.29 \cdot 10^6$ nga diagramet fitohen keto shtresa

Asfalt 8 cm $i=8 \cdot .38=3.05$ cm

Tampon 50 cm $i=50 \cdot .114=5.72$ cm

$i=8.77$ cm

Sipas BS

Per CBR 4% dhe $T=0.75 \cdot 10^6$ nga diagramet fitohen keto shtresa

Asfalt 6.5 cm $i=6 \cdot .42=2.73$ cm

Asfalt bazament 8 $i=8 \cdot .30=2.73$ cm

Tampon 22 cm $i=22 \cdot .11=5.72$ cm

$i=7.57$ cm

Sipas ASHTO tabelave

Asfalt $i=6.1$ cm

Gjithsejt shtresa $i=10.0$ cm

Vlerat mesatare per asfalt $(3.05+5.46+6.1)/3=4.1$ cm

Total trashsia e shtreses $(8.77+7.57+10)/3=8.56$ cm

Pas kalkulimeve te vlerave mesatare dhe shnderrimeve te materialeve ekuivalente

AB 5 cm $i=4 \cdot .44=1.76$ cm

BZ 8 cm $i=8 \cdot .33=2.64$ cm

$i=4.4$ cm

Komplet trashesi e tamponit

$d=(8.56-4.4)/.11=27.8$ cm

Per zone me thelles te ngrirjes prej 70 cm, kerkohet thellesi e ngrirje $70 \cdot 0.8=64$ cm

Pas shtresave te pervetesuara te asfaltit prej 12 cm, mbetet qe nevoiten zhavor

$d=56-12=44$ cm (40 cm)

$d_{me}=(27.8+44)/2=35.8$ cm (pervetesoje 45 cm)

Shprehja me e komplikar e cila merr parasysh me shume faktore per dimensionimin e shtresa sipas RAS standardeve

Npp = TMDTr x fA x qBm x f1 x f2 x f3 x fp

Npp => Ngarkesa nga trafiku në konstruksionin e rrugës

TMDTr => Qarkullimi mesatar ditor i trafikut të rëndë [$A_{ut} / 24h$]

fTR - Faktori i rritjes së ngarkesave për bosht në harmonizim me Bashkësinë Evropiane BE $fTR = fA \times qBm$

fz Faktori për ndryshueshmërinë së TMD për të gjitha kategoritë e rrugëve

N Vite të shfrytëzimit të rrugës N

f1 Faktori i kalimeve

f2 Faktori i gjerësisë së kalimeve

f3 Faktori i pjerrtesis se trases

fz Faktori i rritjes se ngarkesave te renda

Ku pasi te caktohet faktori i pjesmarrjes se ngarkesave te renda ne komunikacion ngatabelat pervetesohet profili adekuat

Perfundimisht pervetesohen keto shtresa

shtresa qarkulluse prej asfalt-betoni 5.0 cm

- shtresa bartëse e zhavorit të bitumenizua 8.0 cm

- shtresa e tamponit prej gureve 0-31.5 15.0 cm

- shtresa e tamponit prej gureve 0-63 35.0 cm

Gjithsejt : 47 cm

AB 11S 5,00 cm

BZ0/22S 8,00 cm 90 MN/

ZH 0/32 15,00 cm

ZH 0/63 35,00 cm

Nen-baze 50 MN/m2

1. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM TEKNIK

4.1.1 Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes per pune si dhe largimi i instalimeve ne punishte

Kontraktori prej momentit te nenshkrimit te kontrates deri ne fillimin e punimeve duhet qe te pergaditet per mobilizim ne punishte ne menyre qe te jete operacional gjate tere kohes se ekzekutimit te punimeve.

Fillimisht Kontraktori duhet qe te pergadise projektin e organizimit te kantierit per pune administrative dhe menaxheriale duhet qe ti kete objektet percjellese hapesirat per laborator mobil si dhe hapesiren per mbajtjen e takimeve me investitorin dhe organin udheheqes. Gjithashtu ne punishte kontraktori duhet te kete edhe hapesiren per dhenjen e ndihmes se pare punetoreve ne rast se vjen deri te ndonje lendim si dhe EC mobile qe duhet te mirembahen gjate tere kohes se ekzekutimit te punimeve.

Mekanizimi i parapare per kryerjen e punimeve dhe organizimi dhe teknologjia e ndertimit te kesaj rruge duhet te jete ne pershtateshmeri te plot me natyren e punimeve qe duhet te kryhen ndersa planet dinamike duhet ta percaktiojn sakte kohen e fillimit dhe perfundimit te secilit aktivitet dhe resurset qe duhet te angazhohen per te.

Organi udheheqes ka te drejte te kerkoj modifikime te caktuara ne projekt te organizimit te kantierit ose ne planet dinamike nese ato nuk jane adekuate me natyren e projektit ne fjale.

Punishtja duhet te jet e rrethuar dhe te jete e vendosur ne afersi te rruges dhe duhet te kete te gjitha instalimet e nevojshme per funksionim normal te punes ,rrymen,ujin kanalizimin,lidhjen telefonike dhe lidhjet e internetit.

Kontraktori eshte i obliguar qe te hape ditarin e punes dhe librin ndertimor ne momentin qe Organi udheheqes i lesheon urdhersen per pune.

Ne periudhen e mobilizimit te punishtes Kontraktori duhet ti pergadise planet dinamike detale per secilin pozicion vec e vec ne menyre qe fillimi i punimeve te jete i sinkronizuar ne keto plane,aprovimi i ketyre planeve eshte ne kompetence te organit mbikeqyres.

Kontraktori eshte i obliguar qe te pergadise edhe Metodologjite per kryerjen e secilit pozicion qe paraprakisht duhet te aprovohet nga ana e organit mbikqyres.

Te gjitha instalimet e rrymes kanalizimit,ujesjellesit dhe telefonis qe gjenden ne rrugen egzistuese dhe ne trupin e ri te rruges duhet qe te largohen nga vendndodhja dhe te rilocohen perkohesisht ne menyre qe funksionimi i tyre te mos nderprehet gjate ekzekutimit te punimeve ne trase.

Kontraktori është i obliguar që të dorëzojë mbikeqyresit planin e perfunduar të vendosjes së këtyre instalimeve.

Vendet dhe pozita e instalimeve të riluara duhet të jetë subjekti i aprovimit nga ana e organit mbikqyres. Përgjithësisht për këto pozicione bëhet në paushall dhe vlerësimi i paushallit duhet të bëhet në bazë të progresit të kontraktorit për kompletimin e kësaj pozicioni.

4.1.2 Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontroll të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në zgjerimet e rrugës.

Fillimisht në fazën e përgaditjes së punës dhe trases Kontraktori është i obliguar që të vendosë shenjat e nevojshme për kontroll dhe orientim të trafikut në mënyrë që trafiku të rrjedhë i pandërprerë gjatë tërë kohës së ekzekutimit të punimeve.

Gjithashtu duhet të vendosen edhe shenjat adekuate të lajmerimit për punë në rrugë në distancë adekuate në fillim dhe në fund të trases si dhe përgjatë trases.

Për të vendosur këto shenja Kontraktori është i obliguar të përgadisë një projekt adekuate të sinjalizimit që paraprakisht duhet të aprovohet nga organi mbikqyres, organi udhëheqës ka të drejtë të kërkojë modifikime të caktuara në projekt të cilat Kontraktori është i obliguar të plotësojë.

Punimet në trasë nuk mund të fillojnë pa u vendosur këto shenja, gjithashtu këto shenja gjatë tërë kohës duhet të mirëmbahen dhe kontrollohen nga ana e kontraktorit si dhe janë subjekti i marrëveshjes me mbikeqyresin lidhur me shtimin ose plotësimin e informacioneve për trafikun gjatë kryerjes së punës.

4.1.3 Vendosja dhe sigurimi i pikave të reja poligonale për përcjellje të punëve gjeodezike në terren

Ky pozicion përfshin:

- mbikeqyrjen e pikave treguese (poligonale) që tregojnë shtrirjen e rrugës dhe të objekteve tjera në rrugë.
- Të gjitha masat e nevojshme për barritjen e të dhënave prej projektit në terren apo prej terrenit në plan dhe
- Mirëmbajtjen e shenjave të vendosura në terren gjatë gjithë kohës, prej fillimit të punëve deri tek pranimi dhe dorëzimi i të gjitha punëve nga punëdhënësi.

Kjo punë përfshinë gjithashtu edhe pranim-dorëzimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha dokumenteve themelore të studimit dhe të planeve dhe shenjave të vendosura në terren, të cilat punëdhënësi ia dorëzon kontraktorit në fillim të punëve.

Shtrirja e këtyre punëve duhet në tërësi të plotësojë nevojat e ndërtimit, kontrollimit e punëve, vlerësimin e harxhimeve, dhe të faktorëve tjerë, të cilët i krijojnë kushtet për ekzekutimin e punëve.

Punët gjeodezike përfshinë gjithashtu edhe prodhimin e planeve ekzekutive e pikave poligonale (të shtrirjes) së rrugës që do të ndërtohet dhe/apo të objekteve tjera. Planet ekzekutive duhet të prodhohen përpara inspektimit teknik të rrugës së ndërtuar dhe/apo të objektit.

4.1.4 Mënyra e ekzekutimit-dorëzimi dhe pranimi i pikave poligonale si dhe shenimi dhe përcjellja e punimeve gjeodezike

Punëdhënësi duhet të dorëzojë kontraktorit të punëve:

- planin e punëve gjeodezike të rrugës që përmbanë këto plotësime siç vijim:
- situatën me përpjesë 1:1000 me vijën e mesit të vizatuar, përpjesa për kilometra dhe një referencë për elementet e rrugës së studiuar. Situacioni gjithashtu përmbanë edhe skemën e pikave kryesore të lidhura me pikat poligonale të vizatuara, me të dhënat e nevojshme për shënimin e tyre.
- kalkulimin e pikave kryesore apo llogaritje elektronike të koordinatave të ndarive kryesore ndërmjet pikave tokësore të rrjetit
- një listë të pikave poligonale (reperëve) me koordinatat dhe topografin e këtyre pikave
- një listë të etapave dhe niveleve të reperëve dhe topografin e këtyre reperëve.

Kontraktori është i obliguar që të rivendosë, bazuar në planin për shënimin e pikave poligonale, vijën e mesit (shtrirjen dhe lartësinë) për krijimin e bazamentit pasi që ai të ketë përfunduar punët. Saktësia e vijës së mesit të rivendosur inspektohet nga ana e inxhinjerit mbikqyres të punëdhënësit.

Kontraktori është i obliguar që të mbrojë të gjitha pikat poligonale dhe reperët që nga dita e pranimi të tyre. Në rast se pikat e caktuara referuese në terren janë humbur apo janë lëvizur (pikat poligonale, reperët), kontraktori është i obliguar që të rivendosë këto pika me harxhime të tija personale. Saktësia e pikave të tilla të rivendosur do të inspektohet nga ana e inxhinjerit mbikqyres.

4.1.5 Mbrojtja e vijës së shënuar të mesit

Kur punëdhënësi pranon vijën e shënuar të mesit të rrugës apo të ndonjë objekti tjetër, ai është i obliguar që të mbrojë secilin profil në të dy anët (pamarrë parasysh konturën e terrenit) për distancën e caktuar

nga skaji I mbushjes apo gërmimit,që këto të qëndrojnë ashtu si janë deri në përfundim të punëve ndërtimore.Secila pikë e mbrojtur duhet të mbrohet me anë të një rami të drurit në formë të trekëndëshit,me profil prej 2.5 cm x 2.5 cm.Hunji mbrojtës me profil 5 cm x 5 cm duhet të ketë një gozhdë,koka e të cilit duhet të jetë e ngjyrosur me ngjyrë të kuqe apo me ndonjë ngjyrë tjetër të qëndrueshme.Çdo mbrojtës duhet të nivelizohet dy herë.

Një tabelë e drurit duhet të qëndrojë në anën e majtë apo të djathtë pran trekëndëshit,ku duhet të shënohet numri I profilit me ngjyrë të kuqe apo me ndonjë ngjyrë tjetër ,numri duhet të jetë I madh dhe nën të të jetë e shënuar distanca (stacionazha) e profilit.

4.1.6. Vendosja e profileve të prerijeve tërthore

Kontraktori, në rast se nuk është I kënaqur me profilet tërthore të dorëzuara të projektit kryesorë,ka të drejtë që ti përseritë matijet e prerijeve tërthore,në kënd të duhur ndaj vijës qëndrore të rrugës,horizontalisht apo takimetrikisht.

Profilet e ndërtimit duhet të vendosen në pjerrtësit dhe mbushjet nën këndin që është I përshkruar në sikcat e prerjeve tërthor të profileve.Pjerrtësit e prerjeve tërthore ndaj terrenit duhet të llogariten matematikisht duke marrë parasyshë në të njëjtën kohë edhe ndërprerjet e specifikuara të pjerrtësive. Profilet duhet të jenë në vend gjatë tërë kohës së ndërtimit të mbushjeve dhe/apo gërmimeve dhe duhet të zgjerohen njëkohësisht me progresin e punimeve.

Profilet ndërtimore duhet të jenë të punuara zakonisht nga tabelat e drurit me një prerije tërthore prej 2.5 cm x 5 cm dhe nga hunjët e drurit me një prerije tërthore prej 2.5 cm x 5 cm.në rast të mushjeve të larta apo gërmimeve lejohet që ato të vendosen në një distancë prej jo më se 50 m.Inxhinjeri mbikqyrës mund të përcaktojë nevojën e vendosjes së hunjëve plotësues në mes të kësaj distance.

Vija e mbushjes apo e gërmimit padhe dhe pa rrafshimin e fundit apo të majës së gërmimit apo të thembrës së mbushjes duhet të konsiderohet në bazë të këndit të pjerrtësisë.

4.1.7 Hunjëzimi (shënimi) I objektit

Kontraktori është I obliguar, që ti shenojë të gjitha objektet në bazë të vlerësimit dhe nevojës së tij,mirëpo ai para së gjithash duhet ti dorëzojë mbikëqyrësit një plan të shënimit me të gjitha të dhënat e nevojshme.Vendosja e profileve tërthore ,mbrojtja e vijës së mesit të shënuar dhe kontrollimi duhet të bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse kur është bërë projektimi I pikave të shtrirjes së rrugës,mirëpo që I adaptohet nevojave të ndërtimit të objektit.

Shënimi I objektit duhet të mbrohet me një mbrojtës nga betoni në të dy anët e hunjit.Plani për shënimin e objekteve të mëdha duhet ti përmbajë llogarit e elementeve për kontrollimin e vendosjes së hunjëve dhe të ndërtimit të shtyllave me prerje tërthore .

4.1.8 Kualiteti I ekzekutimit

Saktësia e matjeve duhet të jetë në pajtueshmëri me normat gjeodezike për llojin e caktuar të matjeve dhe në pajtueshmëri me kualitetin e kërkuar për punët e caktuara në kushtet speciale teknike.

Punët gjeodezike mund të ndërprehen nga ana e mbikëqyrësit në rast se ai konstaton se matjet nuk janë duke u bërë sipas projektit.Me këtë rast kontraktori është I obliguar që të ndërmerr hapa për matje më precize apo për sigurimin e matjeve që I kërkon mbikqyrësi.

4.1.9 Kontrollimi I kualitetit

Kontraktori është I obliguar që ti inspektojë të gjitha pikat e shënuara të shtrirjes së rrugës gjatë tërë kohës së ndërtimit dhe që rregulisht rivendos të gjitha shenjat në terren,pavarsish nga shkalla e dëmtimit.Kontraktori është I obliguar që ti përserisë të gjitha punët e parapara sipas puneve gjeodezike. në rast se ndryshimet janë bërë në projekt.Kontraktori është I obliguar që t'ia dorëzojë të gjitha të dhënat mbi shënimin (hunjëzimin) mbikëqyrësit dhe që ta lejojë atë që ti shfrytëzojë të shenimet për nevojat e tij papengesë.Në rast se mbikqyrësi zbulon se,me matje dhe me kontrollimin e të dhënave, se matjet e kontraktorit nuk janë të sakta,ai ka të drejtë që t'ia dorëzojë të gjitha matjet një organizate të tretë kompetente dhe te ndryshojë çmimin aktual të kontraktorit.

4.1.10 Matjet dhe pranimi I punës

Punët gjeodezike duhet të maten sin ë vijim:

- ☐ -hunjëzimi I pikave për shënimin e shtrirjes së rrugës për kilometër të hunjëve të vendosur,
- ☐ -vendosja e profileve në pjesë prej dy profileve të vendosura njëra pran tjetrës.

Kontraktori është I obliguar që t'ia dorëzojë mbikëqyrësit planin e përfunduar të vendosjes së hunjëve dhe rrugën e ndërtuar apo ndërtimin në tri kopje pas përfundimit të punëve , mirëpo kjo të bëhet përpara

kontrollit teknik. Plani ekzekutiv gjithashtu duhet të përmbajë shenime mbi pikat poligonale dhe reperëve. Një raport pranues duhet të bëhet për këtë.

Kontraktori gjithashtu është i obliguar që ti vendos hunjët në pjesën e mesme të apo pjesën e skajshme të rrugës së shtruar dhe ti shënojë profilet ndërtimore me një ngjyrë të qëndrueshme përpara se të bëhet inspektimi teknik.

4.2 Pastrimi i Terenit

4.2.1. Largimet e Objekteve

Demolimi i objekteve ekzistuese dhe largimi i materialeve që do të mund të pengonin punën, me përjashtim të rastit kur këto punë të jenë specifikuar ndryshe në plane apo të jenë specifikuar ndryshe nga ana e mbikëqyrësit. Në trasen ekzistuese nuk kemi material të veqarë të cilat duhet cekur, pasi në këtë hapësirë kemi një deponi të përgjithshme.

4.3. Punimet Tokësore

Germimi i dheut të kategorisë II – IV të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 10km.

4.3.1 Përshkrimi

Gërmimi përfshinë:

- Duke parapare vëllimin e madhe të largimit të dheut në gjithë gjerësinë e pistes së rrugës punëkryesi duhet patur një plan germimi të veçantë, në bashkëpunim me investitorin dhe në bazë të atij plani të gjithë puna duhet bazuar.

Kjo punë duhet poashtu të përfshijë të gjitha operacionet të cilat nevojiten për gërmimin e materialeve të tepërta të ngriten deri në një nivel të caktuar:

- të gjitha gërmimet e thella për strukturat e ndërtesave të më tepër se 2.0 m gjërësi, të të gjitha kategorive të materialeve dhe deri në qfarëdo thellësie, duke e përfshirë bartjen e

materialit deri në deponi ose deri në likacionet në të cilat materiali do të vendoset në mbushje të ndryshme, mbushje të prapme dhe agregat të thyer për konstruksione. Kjo punë duhet ta përfshijë edhe ngritjen e materialit deri në një nivel të caktuar;

Bartja anash, shkarkimi, dhe shpërndarja e dheut të tepërt joadekuat, poashtu edhe bartja deri në deponi jashtë vend punës. Deponitë jashtë vend punës duhet të sigurohen nga kontraktori i cili i përgatit ato ashtu si i përshtatet (shpërndarja e materialit, mbjellja me bari, drenazha).

4.3.1.1 Materialet bazë

Dheu dhe guri si materiale të siguruar nga vendhuazimet do të jenë materiale bazë që do të përdoren në punët e konstruksionit.

4.3.2 Kualiteti i materialit

4.3.2.1 Klasifikimi

Të gjitha llojet e gurëve të dedikuara për punët e konstruksionit janë të klasifikuara në këto kategori:

- dheu pjellorë Kategoria 1
- dheu i butë Kategoria 2
- dheu koheziv dhe jo koheziv Kategoria 3
- shkëmb i butë Kategoria 4
- shkëmb i fortë Kategoria 5

Klasifikimi i materialeve të dheut dhe të gurit në kategori të ndryshme bazohet në cilësi të ndryshme të cilat kanë ndikim në punë të veqanta në konstruktiv. Makineria moderne që përdoret në operacionet gjatë ndërtimit, ka ndikim në gërmimin, bartjen dhe në vendosjen e materialit.

Tabela 2.1 paraqet listën e kategorizimit të dherave dhe shkëmbinjëve dhe e tregon metodën e gërmimit ose të sigurimit të materialeve të tilla, duke dhënë vlerësimin e e përshtatshmërisë së tyre dhe të karakteristikave të tyre (klasifikimi i materialit të dheut dhe i shkëmbinjëve).

Në rastet kur shtresat e dheut dhe/ose shkëmbit gjatë një gërmimi do të ndërrohen në asi mënyrë që klasifikimi i materialit bëhet i vështirë ose edhe i pamundur, duhet të definohet një lloj mesatarë sipas kategorisë dhe llojit të materialit.

Të gjitha materialet e siguruar nga heqja e ngarkesës së tepërt, nga gërmimi i gjërë, nga gërmimi i fundamenteve, kanaleve të ndryshme, gërmimeve të thella për konstruksione të ndërtesave, kanaleve për bonifikimin e dheut dhe për rregullimin e rrjedhës së ujit të lumnjëve, të kanaleve të drenazhës, të ujës-jellësve të hapur, si dhe gërmimi i kërkuar për mvëshjet e ndryshme me pllaka duhet të klasifikohen në këtë seksion.

4.3.2.2 Kualiteti

Para fillimit dhe gjatë qfarëdo pune, duhet të merren mostra adekuate për testimin e kualitetit të materialit i cili duhet të jetë sipas projektit dhe për qdo ndryshimi të llojit të materialit. Kontraktori duhet ta sigurojë mendimin e ekspertit adekuat për përdorimin e materialit për qdo gjërmim karakteristik të ndonjë sasive të koonsiderueshme, ose të lokacionit nga i cili do të gjërmohen materialet që më vonë do të përdoren si aggregate të gurit për shtresa bazë kohezive dhe/ose jo kohezive, për përzierje të betonit, për material për mbushje, dhe si material për preloading and overloading. Kur materialet e gjërmuara janë të projektuara të përdorim për qëllime të tilla siç janë të numeruara më parë, para minimumit, materiali argjilorë duhet të largohet dhe duhet të përdoret në mbushje ose të hudhet në lokacionin adekuat siç propozohet nga kontraktori dhe lejohet

4.4.1 Gjermimi

1. Gjermimi duhet të jetë me prerje tërthore siç kërkohet me projekt me dukje dhe pjerrësi të siç kërkohet me projekt ose sipas kërkesave të inxhinierit mbikëqyrës.

Gjatë punëve të gjërimit, të gjitha të dhënat nga Regulative e sigurisë në punë duhet të respektohen (vendosja e shtyllave, stabilizimi i pjesëve vertikale dhe të pjerrëta prerja e rrafshëve dhe masa të tilla të ngjajshme); strukturat ekzistuese, vijat e komunikacionit dhe mjetet tjera duhet të mbrohen, dhe mirëmbajtja rutinore e sipërfaqeve publike dhe qasjet në rrugë që do të përdoren duhet të sigurohen.

2. Si rregull, heqja humusit sipërfaqësorë, gjermimi i gjërë, gjermimi i themeleve, kanalet e ndryshme, gjërmimet e thella për themele të ndërtesave dhe kanalet për bonifikim dhe rregullimi i shtretërve të lumenjëve, i kanaleve të drenazhës dhe të ujësjellësve të hapur si dhe gjermimi për vendosjen dhe mbështjelljen me pllaka të sipërfaqeve të ndryshme duhet të punohen duke e përdorur makinerinë për konstruksion dhe mjetet tjera të cilat do ta reduktojnë punën manuale deri në minimum, ashtuqë puna manuale të përdoret vetëm në rastet kur kualiteti i kërkuar nuk mund të arrihet përmes makinerisë për konstruksion, ose kur kjo është e diktuar përmes vetive mekanike të dheut dhe të shkëmbit.

3. Gjatë gjërimit të dherave me aftësi të ulët bartëse. pësha specifike, siç aplikohet në dherat kur përdoret të makineria për konstruktim, duhet të jetë aq sa lejohet nga aftësia bartëse e dheut. Për formimin e pjerrësive dhe të pjesëve të poshtme, pjesërisht do të nevojitet edhe puna manuale, kryesisht për largimin e dheut të shpërndarë përreth. Vetëm dheu pjellorë do të i përdorshëm, dhe mun të përdoret për mbrojtjen dhe mbjelljen e barit në pjerrësitë dhe në mbushjet

4. Shkëmbi i fortë, e ndonjëherë edhe shkëmbi i butë, duhet të gjërmohet me makinë shpuese, për minim të thellë dhe standard, dhe me minim shtesë të gurëve të madhësisë më të madhe, nëse është me projekt kërkohet përdorimi i këtij materiali. Në rastin e projektimit të pjerrësive të lëmuara, duhet të përdoret metoda përkatëse për minim.

5. Rënja e gjërmimeve në pjerrësi varët nga kategoria e dheut, përbërja e lagështisë dhe shtresëzimit të materialit. Këto cilësi mekanike janë të dhëna në me analizat gjeomekanike. Shtresat e shkrifëta të dheut, në të cilat hasim gjatë gjërimit, duke përfshirë edhe shtresë më të lartë të shkrifët dhe zonat e mesit nga materiali i shkrifët, duhet të përdoren, nëse ekzistojnë kushtet për përdorimin e materialeve të tilla; në raste të tjera, sido që të jetë, atyre duhet t'u afroheni sipas projektit ose sipas instruksioneve të inxhinierit mbikëqyrës. Në këtë punë duhet të përfshihet edhe pastrimi i vendeve që kërkojnë masa mbrojtëse të zonave të shkrifta të llojit të përshtatshëm, si p.sh. Mbrojtja e zonave të shkrifëta, xhepave, gropave, burimeve të ujit etj; në punët e tilla nuk janë të përfshira brenda punëve të tjera. Gjatë kryerjes së gjërimit..inxhinieri mbikëqyrës, së bashku me kontraktorin dhe ekspertët përkatës, duhet të vendosin për qfarëdo ndryshimesh të nevojshme duke marrë parasysh pjerrësinë e rënjes së gjërimit, dhe vendimet e tilla duhet të bazohen në cilësitë e dheut, hulumtimet gjeodezike dhe në kushtet tjera të cilat imponohengjatë gjërimit, gjë që duhet të merret në konsiderim nga kontraktori gjatë punëve.

6. Në rastin e rënjeve me pjerrësi prej jo më tepër se 20°, në të cilën do të konstruktohet mbushja duhet të arrihet në proporcionet e keruara sin e projekt.

In case of the slopes with the inclination between 20° and 30°, the spacing between Fundi dhe rënjet e gjërimit të dheutme aftësi të vogël bartëse duhet të jenë të rrafshëta, që të mundësojë vendosjen e filit të polipropilenit dhe/ose që perdja prej materialit gurorë të mund të vendoset në mënyrë të përshtatshme

7. Gjatë ekzekutimit të punëve, kujdes duhet t'i kushtohet evitimit të dëmtimit të pjerrësive të gjërimit. Në qdo rast të tillë dëmtimet duhen me vonë të riparohen nga kontraktori në përputhje me instruksionet e inxhinierit mbikëqyrës dhe për punë të tilla shtesë kontraktorit nuk i lejohet që të kërkojë qfarëdo mbulimi të shpenzimeve apo qfarëdo pagese. Nëse gjatë kryerjes së punëve kontraktori kryen gjermim më të madh se sa që është paraparë (tejkalohej profili i caktuar), atëherë ai duhet ta riparojë këtë profil sipas

standardeve profesionale dhe sipas kërkesave të inxhinierit mbikëqyrës dhe qmimi për këto riparime duhet të mbulohet nga vet kontraktori.

9. Puna e gërmimit duhet të organizohet në asi mënyre që të evitohet qfarëdo pengese e punëve për shkak të shiut apo për shkak të qfarëdo lloji tjetër të ujërave dhe kjo vlen posaqërisht për gërmimin e dherave. Kujdes i posaçëm duhet t'i kushtohet drenimit të ujit nga tereni i gërmuar (përmes rrugës më të shkurtër), dhe të gërmohet vetëm ajo sasi e dheut e cila menjëherë mund të transpotohet me makinerinë e cila është në dispozicion, ose të inkorporohet në strukturën e caktuar. Në rast të mos respektimit të këtyre instruksioneve, pasojat duhet të barten nga kontraktori i cili nuk të drejtë të kërkojë qfarëdo mbulimi të shpenzimeve, e as të aprovojë qfarëdo ndërrimesh të tilla të ecursisë së punës të cilat në qfarëdo mënyre do të ishim të dëmshme për punëdhënësin.

10. Si rregull, gërmimi i dheut me aftësi bartëse të vogël nuk duhet të lihet i hapur për periudhë kohe të gjatë; për këtë është e nevojshme që puna e gërmimit të jetë e koordinuar me mbushjen e prapme. Uji i shiut duhet suksesisht të hiqet me pompa gjatë operacioneve të gërmimit derisa mbushja ta arrijë nivelin e ujërave tokësore. Qmimin për qfarëdo dëmi që mund të paraqitet nëse pompimi nuk kryhet, duhet ta mbulojë kontraktori. Dëmet lokale të sipërfaqeve të pjerrësive duhet të pastrohen dhe të mbushen me material për të cilin shpenzimet i mbulon kontraktori. Për shkak të cilësive specifike të dheut për mbushje, gjatë konstruktimit materiali i gërmuar nuk duhet të deponohet në vendin e gërmimit por duhet menjëherë të ngarkohet në automjete për transport. Nëse gërmimi i dheut ekalon nëpër prerjën tërthore të kanalit për bonifikimin e dheut ose të prronit, duhet të konstruktohet lëshesë e përkohshme me prerje të kërkuar. Duhet shfrytëzuar mundësinë eventuale të derdhjes së një prroni në tjetrin.

11. Në rast të rrezikut nga rrëshqitja e dheut ose të depresioneve të ndryshme, puna duhet të kryhet në shkallë, që të evitohet rreziku nga aksidentet e tilla, ose duhet të sigurohet mbështetje adekuate, posaqërisht nëse është fjala për lartësi më të mëdha.

12. Kur përdoret eksplozivi për qëllime të gërmimit, kontraktori duhet të punësojë punërorë me trajnime dhe kualifikime adekuate. Gjatë punëve me eksplozive ose gërmimeve, qfarëdo pengese për trafik, për njerëzit përreth dhe për vet rrethinën të cilat mund të dalin nga puna e tillë, duhet të reduktohet deri në minimum, dhe duhet të sigurohen shenja përkatëse për sigurinë e trafikut si dhe sisteme të caktuara të signalizimit. Nëse, lajmërohet qfarëdo pengese, duhet të eliminohet menjëherë nga kontraktori i cili duhet t'i mbulojë të gjitha shpenzimet. Nëse metoda e minimumit e aplikuar nga kontraktori shkakton ndonjë dëm të masivit shkëmborë, kontraktori duhet ta riparojë dëmin dhe shpenzimet për riparimet e tilla duhet ti mbulojë vet kontraktori.

13. Gjatë kryerjes së operacioneve të tilla në afërsi të vendeve ku zhvillohet trafiku dhe në afërsi të ndërtesave, duhet të ndërmirren masa shtesë të sigurisë. Gjatë kryerjes së

minimeve ose punët e gërmimit krejtë afër përquesve të rrymës elektrike dhe në afësi të vijave telefonike, duhet të zbatohen rregullativat e aplikueshme dhe duhet të sigurohet pajtimi nga autoriteti kompetent.

14. Hapjet e themeleve për ndërtesa duhet të jenë të profiluara sipas projektit (sa i përket gërmimit vertikal si dhe pjerrësive dhe bazës). Kjo punë duhet të përfshijë sistemet e drenazhës, kanalet, dhe pusetat e nevojshme gjatë konstruktimit, dhe ndërtimin e tyre në lokacionet të cilat do ta mbrojnë kanalin e drenazhës nga shirat dhe ujërat e burimeve. Stabilizimi anësorë përmes mjeteve përkatëse të hapjeve për themele të ndërtesës, kur kërkohet për shkak të cilësive mekanike të dheravedhe të kushteve gjeologjike, duhet të kryhen në përputhje me praktikën profesionale. Metoda e stabilizimit të mureve vertikale duhet të zgjidhet nga vet kontraktori, i cili duhet të jetë i obliguar që ta parashtrojë skemën e tij të menurës së stabilizimit (me llogari statike) për aprovim të inxhinierit mbikëqyrës, pos në rastet kur skema e tillë është e përfshirë në projekt dhe është në përputhje me të. Nëse gjendja e ekzekutuar do të dallohet në qfarëdo mënyre nga projekti, kontraktori duhet menjëherë të ndërmari masa adekuate dhe duhet ta informojë inxhinierin mbikëqyrës për masat e ndërmara.

15. Gjatë gërmimit të kanaleve për bonifikim, materiali i gërmuar përkohësisht mund të deponohet në një distancë të përshtatshme nga skaji i sipërm i kanalit, në të dy anët, nëse lejohet nga kushtet e dheut dhe nga rrethanat tjera, e nëse kjo nuk mund të bëhet, atëherë vetëm me një anë. Dheu pjellorë duhet të ndahet nga materialet tjera. Puna duhet të organizohet ashtuqë në rast të kohës së keqe (fortunat) puna e

tillë nuk do të pësojë kurrëfarë dëmsh. Për ta siguruar këtë, kontraktori duhet që gjatë tërë kohës të sigurojë mjete efektive për drenim të të gjitha llojeve të ujërave (përfshirë ujërat e burimeve) që si të tillë (të kryer) nuk do t'i shkaktohen kurrëfarë dëmsh. Nëse projekti nuk e përcakton përdorimin e materialeve të gërmuara për qëllime specifike, pas përfundimit të të punëve materialet duhet të shpërndahen dhe/ose të largohen jashtë në deponitë e projektuara për qëllime të tilla, duke siguruar që deponimi i dherave pjellore të jetë shtresa përfundimtare e masës së deponuar.

Puna duhet të kryhet ashtuqë të arrihet rënja tërthore dhe gjatësore e kërkuar me projekt. Në princip uji inert, i palëvizshëm nuk do të duhet të lejohet që të paraqitet kudo. Të gjitha rrënjët barishtet dhe pengesat e tilla duhet të pastrohen dhe të priten pa pagesë të posaqme për këtë punë.

16. Kanalet e drenazhës dhe kanalet e hapura të ujësjellësit duhet të gërmohen sipas projektit. Të gjitha sipërfaqët e gërmuara duhet të jenë të rrafshëta duke e siguruar pjerrësinë e kërkuar dhe rrumbullakësimin, që të evitojë ujin inert, të palëvizshëm ose dëmet e dheut të paprekur apo të kontaktuar.

Gjatë punës, ndikimi i mundshëm nga ndryshimet e mundshme klimatike në sipërfaqet e gërmuara duhet të merret parasysh nga kontraktori i cili duhet të sigurojë që punët duhet të organizohen në asi mënyrë që të janë të kompletuara në të njëjtën kohë, ose që të jenë menjëherë të përcjellura nga gërmimi i kanaleve të drenazhës dhe kanaleve të hapura të ujësjellësit. Shpenzimet e qfarëdo punëve shtesë dhe të punëve tjera të mëpastajme, nëse kontraktori nuk i kryen punët e përmendura të drenazhës duhet të barten nga kontraktori.

Në rast të kontruksionit me aftësi bartëse të vogël, me mbushja anësore të projektuara për konstruktim, duhet të ekzekutohet kanali i drenazhës përgjatë skajit të jashtëm të mbushjes anësore para gërmimit, ose paralelisht me nivelizimin e dheut. Pas kompletimit të punëve, kanalet e drenazhet duhet të përfundohen ose të riparohen. Kanaleët e përhershme anësore të drenazhës duhet të lidhen me ato ekzistuese, me kanalet e rregulluara të bonifikimit ose me kanalet e tjera të përhershme të drenazhës.

17. Gërmimet për mvëshjet me pllaka dhe për mvëshjet mbrojtëse duhet të kryhen në mënyrë strikte sipas projektit ose sipas instruksioneve të inxhinierit mbikëqyrës.

Planumi i rrugës i cila do të mvëshet me pllaka ose me ndonjë shtresë mbrojtëse duhet t'u përgjigjet kushteve të posaqme, varësisht nga lloji i mvëshjes me pllaka apo i shtresës së përdorur mbrojtëse të paraparë me projekt.

4.4.1.1 Balancimi i sasive

Materialet e gërmuara duhet të përdoren sipas projektit, në rend të parë duke i marrë parasysh punët e kontraktuara (mbushjet, mbushjet e prapme, konstruksionin e agregatit të thyer derisa teprica e mbetur e materialit ose materiali joadekuat për nevojat e konstruksionit duhet të vendoset sipas projektit ose në mbushjen e prapme ose të hudhet në deponinë e caktuar të materialit të papërdorshëm. Çmimi i ngarkimit, transportit, shkarkimit shpërndarja dhe rrafshimi i materialit të tepërt dhe mbushja e prapme dhe kompaktimi i materialit për mbushje duhet të jenë të përfshiera në çmimin njësi. Kur ka nevojë, inxhinieri mbikëqyrës duhet të sigurojë instruksionet detale nëse përdorimi i materialeve të gërmuara, dheut dhe gurit nuk është i përcaktuar sipas projektit. Në princip, balancimi i sasive duhet të kryhet sipas projektit ose sipas grafikontit të dinamikës së bartjes së masës së dheut e cila duhet të jetë ndihmesë e caktuar gjatë formimit të çmimit.

4.4.1.2 Vendi i ekspluatimit

1. Nëse përdorimi i materialit nga vendi i caktuar për ekspluatim është i përcaktuar sipas projektit dhe nëse ekspluatimi i tillë i materialit është i lidhur me koston, kontraktori dhe inxhinieri mbikëqyrës duhet që së bashku ta kryejnë shqyrtimin e lokacionit të caktuar para qfarëdo përdorimit të materialit. Raportet e shqyrtimit të siguruara në këtë mënyrë – të aprovuara dhe të shënuara nga të dy palët – duhet të përdoren gjatë llogaritjes së sasive.

Kontraktori duhet:

- Të propozojë tretmanin e vendit prej nga është marrur materiali kur ekspluatimi të vij në përfundim;
- Të sigurojë aprovimin e inxhinierit mbikëqyrës për tretmanin e propozuar të vendi të ekspluatimit, dhe
- Të marrë masa të caktuara në vendin e ekspluatimit në përputhje me propozimin e aprovuar.

2. Nëse kurrëfarë specifikacioni për ekspluatimin e materialit, për sigurimin e sasive të mjaftueshme të materialit, nuk është i dhënë me projekt, derisa në sipërfaqen ku konstruktohet rruga ka mungesë evidente të materialit, vendi i ekspluatimit duhet të sigurohet nga vet kontraktori. Në raste të tilla, kontraktori duhet (me shpenzime të veta) ta demonstrojë kualitetin dhe kuantitetin e materialeve në

dispozicion në vendin e eksploatimit dhe t'ia parashtrojë inxhinierit të mbikëqyrjes për aprovim këtë lokacion për eksploatimin e materialit (përfshirë planin e situacionit dhe prerjet tërthore)

Plani I situacionit duhet të tregojë lokacionin në të cilin duhet të deponohet dheu pjellorë, materiali tjetër shtesë dhe materiali joadekuat për konstruktiv. Në bazë të propozimeve të tilla dhe kualitetit të demonstruar të materialit inxhinieri mbikëqyrës do ta jap aprovimin e tij për përdorimin e vendit të caktuar për eksploatim.

3. Kontraktori duhet që me kohë ta sigurojë aprovimin e inxhinierit mbikëqyrës për qfarëdo ndryshime të mëvonshme (zgjerimet dhe rritjet eventuale të thellësive) të vendit të eksploatimit. Të gjitha shpenzimet e punëve të tilla të cilat nuk janë të përfshiera në projekt

duhet të barten nga kontraktori, duke përfshirë sigurimin e lejes për përdorimin e tokave të punueshme dhe të tokave të tjera, si dhe për qdo dëm tjetër të shkaktuar nga këto rrethana.

4. Gjatë hapjes dhe eksploatimit të vendeve të eksploatimit, duhet të punohet drenazha e ujërave atmosferike dhe nëntokësore.

4.4.1.3 Ndërhryjet

Ndërhryjet për kanalet e ndryshme dhe/ose procedurat dhe metodat tjera për kryerjen e punëve të tilla mund të merren përsipër nga kontraktori nëse metodat e tilla të konstruktimit nuk do të kenë kundër efekt në kualitetin e punëve të ekzekutuara dhe nëse kontraktori nuk do të kërkojë qfarëdo pagese shtesë.

4.4.1.4 Pengesat

Nëse gjatë gërmimit haset në qfarëdo pengesa të papritura, si tuba, kablllo, kanale, elemente të drenazhës, mbeturina të strukturave, gurë të mëdhenjë, gurë për kufizime dhe kufij të ndryshëm, ose të ngajshme duhet menjëherë të informohet inxhinieri mbikëqyrës. Inxhinieri mbikëqyrës atëherë duhet t'i caktojë masat që duhet t'i ndërmar kontraktori.

Masat mbrojtëse që ndërmerren nga kontraktori në lidhje me strukturat, tubat, kanalet, kabllot, dhe elemente të tjera të ngajshme duhet të jenë në përputhje me rregullativat dhe instruksionet e entiteteve përgjegjëse. Mjetet të cilat kërkojnë të jenë të mbështetura apo të hequra nga ndonjë strukturë speciale gjatë konstruksionit nuk lejohet të jenë të ngarkuara apo të kalohet nëpër to.

4.4.1.5 Kualiteti I punës së kryer

Punët e gërmimit duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të sigurohet kualiteti adekuat dhe konform kërkesave të këtyre kushteve teknike. Sipërfaqet ku ka përfunduar gërmimi duhet të jenë të përfunduara sipas projektit.

Në gërmim të gjërë, rrafshësia e planumit, e matur me shufrën 4 m të gjatë mund të devijojë:

- Jo më tepër se 3 cm nga shufra matëse ose rrafshi matës, kur gërmohet dheu, dhe
- Jo më tepër se 5 cm, kur gërmohet shkëmbi.

Gërmimi I kanaleve të drenazhës, të kanaleve të hapura të ujësjellësit, rregullimit të shtratit të lumejve dha kanaleve të bonifikimit, duhet të kryhen në mënyrë që të sigurojnë kullimin e papenguar të ujit. Gërmimi I kanaleve të drenazhës, të kanaleve të hapura të ujësjellësit, rregullimit të shtratit të lumejve dha kanaleve të bonifikimit, të projektuara të kryejnë funksionin e ndonjë lloji të mvëshjes ose të qfarëdo korigjimi duhet të jenë të ndërtuara konform masave nga projekti. Qfarëdo ndryshimi si rezultat I të cilit zvoglohet trashësia e strukturës së mvëshjes apo e korigjimit të kërkuar, nuk është e lejuar. Gjatë kryerjes së punëve të gërmimit, kontraktori duhet ta informojë inxhinierin mbikëqyrës për të gjitha problemet e shkaktuara të cilat mund ndikojnë në kualitetin e punëve të kërkuara sipas këtyre kushteve teknike. Nëse kontraktori nuk vepron në këtë mënyrë, ai do të jetë ekskluzivishtë përgjegjës për riparimet eventuale, dhe duhet t'i bartë të gjitha shpenzimet e shkaktuara. Të gjitha testet rutinore të punëve duhet të kryhen nga kontraktori sipas këtyre kushteve teknike.

4.4.1.6 Matja e punëve Matja e punëve të ekzekutuara duhet të kryhet sipas Kushteve të Përgjithshme Teknike dhe kërkesave si vijon:

- Të gjitha gërmimet (heqja e humusit, gërmimi I gjërë, gërmimi I fundamenteve, kanaleve shërbyese, gërmimet për themele të ndërtesave, gërmimet për rregullimin e shtratit të lumejve, për kanale të bonifikimit, kanaleve të drenazhës dhe të ujësjellësve të hapur, si dhe gërmimet e kërkuara për shtresa për shtruarje dhe mvëshje) duhet të maten ashtuqë t'i tregojnë sasi të realishtë të gërmuara, të matura me metër kub të klasave të ndryshme të materialit në gjendje natyrore, (të para fillimit të gërmimit)
- Për t'i caktuar sasi të reale të gërmuara, duhet të përdoren prerjet tërthore, të cilat të cilat duhet të determinohen para fillimit të ekzekutimit të gërmimit. Duhet të matet sipërfaqja e prerjes, e matur nga skaji I epërm I gërmimit deri te përfundimi I gërmimit

- Nëse merret parasyshë trashësia e shtresave të veqanta dhe kategoria e materialit si dhe distanca mes prerjeve, si dhe sasia e përdorur për kalkulim në paramasë, sidoqoftë, vetëm sasia brenda përshkrimit të punëve në projekt ose ndryshimet e aprovuara ose të kërkuara nga inxhinieri mbikëqyrës.

Për sa l përket matjeve, duhet të merren parasyshë veqanërishtë edhe:

- Me heqjen e humusit, trashësia e shtresës së hequr nuk duhet të jetë më e madhe se 40 cm.
- Në gërmimin e gjërë, deformimet eventuale të gërmimit si lentat, xhepat, gropat më të vogla se 1 m² (prerja tërthore) nuk duhet të merren parasyshë, derisa ato me dimension më të madh duhet të hiqen nga sipërfaqja e përgjithshme e materialit të gërmuar
- Për caktimin e thellësisë mesatare të tipeve të përmendura të gërmimit, si nivel referent duhet të merret niveli mesatarë l terrenit dhe vëllimi l gërmimit
- Me gërmimin e kanaleve të drenazhës, niveli mesatarë l dheut dhe niveli l gërmimit sipas aksit të prerjes tërthore, që e përfaqësojnë vlerën mesatare të të dy niveleve skajore të dheut në gjendje natyrore (të para fillimit të gërmimit) në pikat ekstreme të kanalit.

l tërë materiali l gërmuar l cili do të përdoret për qfarëdo qëllimi tjetër përveq si mbështetjë anësore ose mbushje e prapme, dhe nëse nuk zëvendësohet me material nga ai l eksploatuar (pa kërkesë për pagesë plotësuese), duhet të hiqet gjatë caktimit të sasive për llogaritje.

4.4.1.7 Pranimi l punëve

Punët e ekzekutuara duhet të pranohen sipas l Kushteve të Përgjithshme Teknike dhe këtyre Kushteve të Posaçme Teknike.

4.4.1.8 Llogaritja e çmimeve

Vlera e punës së kryer duhet të llogaritet sipas Kushteve të Posaçme Teknike.

Për sasi të llogaritura çmimet duhet të llogariten në bazë të çmimit kontraktues njësi për m³ të materialit të gërmuar, ndamas për çdo kategori të materialit, dhe në këtë çmim njësi duhet të përfshihen:

- Të gjitha punët e gërmimit, ngarkimit, transportit dhe deponimit në vend të caktuar apo në deponi, të kryera sipas projektit ose sipas instruksioneve të inxhinierit mbikëqyrës;
- Të gjitha punët e pastrimit (heqjes së rrënjëve dhe kaçubave), përfshirë edhe gërmimin e dherave me aftësi të ulët bartëse dhe me plasticitet të lartë ose konsistencë viskoze;
- Të gjitha punët e deponimit të materialit dhe të përgatitjes së deponive të përkohshme apo të përhershme për deponimin e materialit të tepërt apo joadekuat;
- Sigurimin e tokës së përshtatshme për deponi të përhershme apo të përkohshme, përfshirë edhe kryerjen e dëmshpërblimeve përkatëse për shfrytëzimin e tokave;
- Rrafshimin e të gjitha gërmimeve dhe tokat shtesë të përfshiera

Pastrimin e terrenit pas përfundimit të punëve dhe bartjen jashtë të materialit tepricë;

- Heqjen e të gjitha pengesave të qfaqura gjatë punëve, përveq pengesave me rëndësi historike dhe kulturore:

- Mirëmbajtjen e punëve të kryera deri në pranimin përfundimtarë.

Përveq asaj që u përmend më parë, çmimi njësi duhet të përfshijë edhe:

- Në rast të gërmimit të gjërë:
- Përgatitjen e pjerrësisë dhe heqjen e blloqeve të gurit dhe mbeturinave të tjera nga pjerrësia, dhe
- Gërmimi l kaskadave, për shkak të kërkesave nga projekti ose për shkak të nevojave që tregohen më pastaj.

- Në rast të qfarëdo gërmimi të fundamenteve apo të kanaleve shërbyese:

- Stabilizimin anësorë dhe pahinë e nevojshme të kanaleve për fundamente dhe shërbime, sipas kërkesës ;

- Në rast të gërmimit të themeleve për objekte ne rruge:

- Pahinë adekuate të vendosur në gropën e gërmuar të fundamentit;

- Kthimin në gjendje fillestare të strukturave dhe sipërfaqeve të afektuara dhe

- Stabilizimin anësorë dhe pahinë e nevojshme të pjerrësive të gropës të fundamentit të ndërtesës

- Në rast të gërmimit për rregullimin e shtratit të lumit dhe tokës për kanalet e bonifikimit:

- Punët në formacion të profilit për shtruarjen e rrugës dhe mvëshjes sipas projektit; ky qëndrim duhet të aplikohet për rastin e shtruarjes dhe mvëshjes së kanaleve ekzistuese.

4.5.1 Formesimi dhe ngjeshja e nenbazes se trupit te rruges me ngjeshmeri 40 MN/m2

Pas kompletimit të operacioneve te rrafshimit dhe përzierjes, nënshtresat ezisteuse të dheut dhe dherat e përmirësuar dhe/ose të stabilizuar në nështresa të dheut duhet të kompaktohen përgjatë tërë gjërësisë të shtresës së dheut duke përdorur cilindra me rrotë të lëmuara apo me rrotë pneumatike. Vendet në të cilat cilindri nuk ka qasje duhet të kompaktohen sipas projektit duke përdorur mjete dhe operacione të tjera për kompaktim të cilat duhet të aprovohen nga inxhinieri mbikëqyrës I cili poashtu duhet t'i përcaktojë kushtet sipas të cilave duhet të përdoren këto mjete dhe të kryhen këto operacione. Para qfarëdo operacioni të kompaktimit, duhet të testohet përshtatshmëria e tyre për përdorim sipas Kushteve të Përgjithshme Teknike.

Para fillimit të kompaktimit, nënshtresa e dheut ekzistues, nënshtresa e përmirësuar, dhe/ose përzierja e stabilizuar duhet të përmbajnë aq ujë sa të mund të kryhet kompaktimi adekuat. Nëse ka nevojë, Inxhinieri mbikëqyrës mund të caktojë procedura plotësuese, të cilat do të sigurojnë përbërje adekuate të lagështisë dhe vendosje adekuate të dheut, shkëmbit dhe/ose të përzierjes. Kur, pas operacionit të kompaktimit dhe pas testeve të kualitetit të planumit të shtratit të rrugës, mbushja, mbushja e prapme dhe vendosja e agregatit të thyer nuk kryhen menjëherë, por pas ndonjë periudhe të gjatë dhe në kushte të ndryshueshme klimatike, para përfundimit të punëve, duhet të verifikohet edhe njëherë shkalla e kompaktimit të nënshtresës së planumit. Punët mund të përmbillen nëse kualiteti tregohet si konform kërkesave.

4.5.1.1 Aftësia bartëse

Kur nuk matet shkalla e kompaktësisë, aftësia bartëse e nënshtresës së planumit duhet të dëshmohet nga kontraktori përmes rezultateve të testeve rutinore përmes matjes së modulit të deformimit E_{v2} . Vlerat e kërkuara të modulit të deformimit E_{v2} janë të dhëna në Tabelën 2.2.

Koeficienti i modulit të deformimit E_{v2} : E_{v1} nuk duhet t'i tejkalojë vlerat nga Tabela 2.2. Nëse vlerat e amtura të modulit të deformimit E_{v1} arrijnë 50% të vlerës së kërkuar të E_{v2} , koeficienti i kërkuar nuk duhet të jetë meritore gjatë caktimit të aftësisë bartëse të nënshtresës së planumit. Si rregull, aftësia bartëse e nënshtresës të planumit, përfshirë edhe dheun e përmirësuar dhe/ose të stabilizuar kimikishtë nuk duhet të testohet më herët se 7 ditë pas kompaktimit. Vlerat e kërkuara të aftësisë bartëse sipas Tabelës 2.2 paraqesin vlerat më të ulëta kufitare. Vlerat minimale të secilës matje (deri në 5% të numrit të tërësishëm të matjeve) mund të jetë më i vogël ose i njëjtë me 20%. Nëse vendet me aftësi bartëse joadekuate të nënshtresës së planumit duhet menjëherë të caktohen nga inxhinieri mbikëqyrës në bazë të rezultateve të testeve rutinore dhe/ose testeve kontrolluese, e pastaj inxhinieri mbikëqyrës sipas të drejtës së tij vendos për masat që duhet më tutje të ndërmerren.

Tabela 2.2 Përshkrimi i punëve		Shkalla e kërkuar e kompaktimit sipas dendësisë së materialit PSP PMP %	Aftësia bartëse e kërkuar E_{v2} MN/m2
--------------------------------	--	---	--

Planumi I	92	-	-
nënshtresës më shumë se 2 m nën nivelin e planumit	92	-	-
të shtratit të rrugës, nga:	95	-	15
- Dheu	95	-	20
- Dheu I përmirësuar	95	-	30
- Dheu kimikishtë I stabilizuar	-	92	60
- Shkëmbi	98	-	20
	98	-	25
	98	-	40
	-	92	80
Niveli i planumit maximum 0.5 m nën shtresën mbyllëse të nivelit të formacionit			
- Dheu			
- Dheu I përmirësuar			
- Dheu kimikishtë I			

stabilizuar
- Shkëmbi

Niveli i planumit
maximum në
shtresën mbyllëse
të nivelit të
formacionit
- Dheu
- Dheu I përmirësuar
- Dheu kimikishtë I
stabilizuar
- Shkëmbi

Me dhera ekzistuese dhe të përmirësuara dhe/ose nënshtresa të stabilizuara kimikishtë, - jo më tepër se 3 cm

- Me materiale shkëmbore - jo më tepër se 5 cm

4.5.1.3 Niveli i Planumit

Në cilëndo pikë, nënshtresa e planumit mund të devijojë nga niveli I kërkuar deri në këtë masë:

Dherat natyrore dhe me kualitet të përmirësuar dhe/ose me planum të stabilizuar kimikishtë, jo më tepër se ± 2.5 cm

Materialet shkëmbore, jo më tepër se ± 4 cm

4.5.1.4 Kontrolli i kualitetit të materialit

Kur fillohet me përmirësimin e nënshtresës, cilësitë karakterisike të materialeve, të caktuara përmes testeve të mëparshme, duhet të kontrollohen që të verifikohet se janë konform cilësive të testeve të mostrave të materialeve të marruna në fillim të punëve.

4.5.1.5 Testet preliminare

Në fillim të punëve, përmes testeve preliminare duhet të verifikohen këto të dhëna (përmes testeve përkatëse dhe sipas instruksioneve të inxhinierit mbikëqyrës):

- përshtatshmëria e përdorimit të materialit (sipas seksionit 1.3.1) duke marrur së paku 2 ose 3 mostra;
- sasia e binderit të shpërndarë (sipas seksionit 2.2.4.2) duke marrur së paku 2 ose 3 mostra;
- shkalla e kompaktimit të nënshtresave të planumit duke kryer së paku 15 matje të dendësisë dhe të përbërjes së lagështisë në materiale, sipas analizave izotopike (sipas seksionit 1.3.4);
- aftësia bartëse e nënshtresës së planumit (sipas seksionit 1.3.4.1) duke marrur së paku 3 mostra;
- rrafshësia dhe niveli i nënshtresës së planumit (sipas seksionit 1.3.5) duke marrur së paku 3 mostra;

Para fillimit të punëve, operacionet teknologjike, lloji i mekanizimit për kompaktim dhe thellësia efektive duhet të për secilin material karakteristik nën nënshtresën e planumit.

4.5.1.6 Testet rutinore

Në bazë të rezultateve të testeve preliminare inxhinieri mbikëqyrës I cakton vistrën e testeve rutinore të stabilizimit të nënshtresës së planumit:

1. Testet rutinore të materialeve, binderëve, dhe përzierjeve të stabilizuara, të cilat duhet të ekzekutohen nga kontraktorët para fillimit të vendosjes, duhet të përfshijnë: Testimin e materialeve:

- Përbërjen e lagështisë (vetëm të dherave) per qdo 40 m₁
- Përbërjen e humusit per qdo 400 m₁
- Kufijtë e konsistencës së dherave per qdo 400 m₁
- Lagështinë optimale të përzierjes dhe dendësinë per qdo 400 m₁

2. Testet rutinore që duhet të kryhen nga kontraktori gjatë oper qdoacionit të vendosjes duhet të përfshijnë:

- Matja e përbërjes së lagështisë dhe dendësia (analiza izotrope) per qdo 20 m₁

Matja e aftësisë bartëse (moduli I deformimit) per qdo 100 m₁

- Matja e vrazhdësisë së planumit per qdo 20 m₁
- Matja e nivelit të planumit per qdo 40 m₁

Në rast të devijimeve të mëdha nga rezultatet e testeve preliminare duhet të zbulohen testet rutinore dhe inxhinieri mbikëqyrës mund të urdhërojë nderrimin e menjëhershëm të vistrës së testeve rutinore. Në rast të konformitetit të rezultateve, inxhinieri mbikëqyrës mundet poashtu ta zvoglojë vistrën e testeve rutinore.

4.5.1.7 Matja e punëve

Puna e kryer matet sipas seksionit 1.3.6 të llogaritet në metra katrorë. Te gjitha sasi të janë të matura sipas gjendjes aktuale dhe sipas llojit të punëve sipas paramasës nga projekti

4.5.1.8 Pranimi I punëve

Nënshtresa e planumit të vendosur pranohet nga inxhinieri mbikëqyrës sipas kërkesave për kualitet të këtyre kushteve teknike dhe sipas seksionit 1.3.6 Të gjitha mangësitë e zbuluara sipas këtyre kërkesave duhet të korigjohen nga kontraktori para vazhimit të punëve, përndryshe aplikohen zbritjet (deduksionet) për shkak të kualitetit joadekuat. Të gjitha shpenzimet për korigjimin e mangësive i heq kontraktori duke përfshirë edhe shpenzimet e e matjeve dhe të testeve që kanë treguar kualitetin joadekuat të punëve edhe njëherë pas korigjimit të kryer. Për tërë punën e cila nuk i përgjigjet kualitetit të kërkuar sipas këtyre kushteve teknike (kur ato i tejkalojnë vlerat kufitare apo vlerat ekstreme kufitare) dhe kontraktori nuk i ka korigjuar sipas instruksioneve të inxhinierit mbikëqyrës, ai nuk mund ta justifikojë asnjë kërkesë për pagesë. Punëdhënësi në këto raste mund të kërkojë zgjatjen e garancionit për të gjitha punët që varen nga punët e pariparuara për së paku pesë vite.

4.8 Punimi I tamponit (120MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm dhe Punimi I tamponit (150MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me cm dhe bazës stabilizuese (70MN/m²).

4.8.1 Në përgjithësi

Bazamenti i rrugës është pjesa e konstruksionit të rrugës mes shtresës qarkulluese dhe nënshtresave të rrugës.

Ato duhet të ndërtohen me dimensione të caktuara sipas projektit dhe të në përputhje me këto kushte teknike. Konstruksioni i pastabilizuar i bazamentit të rrugës (të stabilizuar mekanikisht) përfshinë furnizimin dhe vendosjen e masës së përzier gjegjëse të grimcave për bazamente të pastabilizuara të rrugëve në vend, të caktuar sipas projektit. Kjo punë duhet të kryhet kur temperatura është mbi 2°C dhe pa të rreshura. Bazamentet e pastabilizuara (BPRR,) mund të punohen në konstruksionin e rrugës për të gjitha llojet e ngarkesave të trafikut, përgjithësisht mes fundamentit të nënshtresës dhe bazamentit të stabilizuar të rrugës.

4.8.1.1 Materialet themelore

Materialet themelore për BPRR janë agregatet natyrore të granuluara dhe/ose të përziera. Masat e përziera të agregatit të thyer kanë granulometri të prodhuar me thyerjen e gurit natyrorë, dhe të gurit artificial. Në këto Kushte të veqanta teknike termat që përdoren për masat e përziera granulometrike janë të treguara në tabelën 3.1.

Në këto kushte teknike termat e përdorura duhet të kuptohen në këtë mënyrë:

- "Klasa - madhësia" (emërtimi për masën e përzier granulometrike) dhe klasa - madhësia e fraksionit është masë e përzier e grimcave të gurit të cilat përmbajnë pjesën më të

madhe të masës së grimcave të masës së përzier të përmendur, por gjithashtu një pjesë me grimca me të mëdha dhe më të vogla.

- "Grimcat më të vogla" janë ato të cilat gjatë sitjes bijnë nëpër sitën standarde për fraksione të madhësisë adekuate më të ulët.

- "Fraksioni" është masë e përzier e grimcave të gurit e kufizuar nga hapjet më të vogla dhe më të mëdha në sitën standarde, pa material tjetër me madhësi më të madhe ose më të vogël

- "Klasa - madhësia" është emërtimi për madhësinë e hapjes së sitës më të vogël standarde nëpër të cilën grimcat ende kalojnë.

- Grimcat e gurëve me klasë të njëjtë janë përbërje e pjesëve koresponduese e të gjitha fraksioneve të masës së përzier të përmendur të grimcave të gurëve.

- Klasa – e veçantë e masës së përzier të grimcave të gurit prej një fraksioni themelorë

- Të thyera janë ato grimca sipërfaqja e 50% të të cilave është thyer.

- Materiali prej gurit të thyer është term për grimcat të thyer nga natyra deri në madhësi të caktuar,

- Zhavorri është term për masën e përzier të grimcave nga natyra të lëmuar, me madhësi të caktuar pavarësisht nga tereni (me zhavorr, me rërë).

- Zhavorri është masë e përzier e grimcave natyrore sipërfaqja e 50% të të cilave është mbi 2mm dhe është i lëmuar.

- Guri i thyer është masë e përzier e grimcave të gurit në të cilin të gjitha grimcat fitohen duke thyer masat e gurit, ose masivet e gurëve artificial, shkëmbijtë e thyer natyrorë.
- Zhavorri i thyer dhe grimcat e zhavorrit janë masë e përzier e grimcave të fituara nga thyerja e grimcave natyrore të cilat përmbajnë së paku 90% (m/m) grimca të thyera më të mëdha se 2 mm.
- Mbushje janë grimcat e gurit të cilat gjatë sitjes kalojnë nëpër sitën standarde 0.09. Mbushja është masë e përzier e fraksioneve prej 0/o.09 mm të grimcave të gurit.
- Rëra është fraksion i perzierjes së grimcave të gurit të cilat gjatë sitjes kalojnë nëpër sitën standarde prej 2mm dhe ngelin në sitën prej 0.09 mm.
- Zhavorri është fraksion i masës së përzier natyrore te grimcave të gurit ku secila granulë ka së paku 50% të sipërfaqes të lëmuar dhe e cila gjatë sitjes kalon nëpër sitën standarde prej 63 mm dhe ngelet në sitën prej 2 mm.

Tabela 3.1

Madhësia adekuate G r a n u l a c i o n i Emri i masës së përzier së grimcave te gurit

Fraksioni prej mm deri mm

mm

0/1* 0 2

0/2 0 4 rëra

0/4 0 4

0/8 0 11.2

0/11* 0 16

0/16 0 22.4

0/22* 0 31.5 zhavorr, guri i thyer

0/32 0 45

0/45* 0 63

0/63 0 125

* madhësia adekuate mesatare, fraksioni mesatarë 4.8.1.2 Granulimi (Përbërja granulometrike) e masës së përzier të grimcave të gurit

Masat e përzier të grimcave të gurit natyrorë ose të thyer dhe masat e përzier të grimcave të gurit të përzier duhet të jenë të përbëra nga grimcat e zhavorrit ose të gurit të thyer ose zhavorrit dhe gurit të thyer, rërës dhe mbushjes, në atë mënyrë që të sigurohet që përbërja e masës së agregatit të jete mbrenda lakoreve standarde granulometrike dhe atë për të dy llojet e materialeve të tamponeve 0-32 dhe 0-63.

4.8.1.3 Cilësitë mekanike

Forca në shtypje e grimcave të masës së përzier duhet të jetë së paku 100 MN/m².

Rezistenca e grimcave në thyerje, e definuar si sitje sipas metodës së Los Angelesit për BPRR për rrugë, lejohet të jetë:

Rezistenca e grimcave të gurit ndaj ngrirjes, e caktuar për grimca mbi 4 mm në 5 cikle të testit të kristalizimit (me natrium sulfat) dhe i shprehur në përqindje të pjesëve të thyera të masës mostër origjinale, lejohet deri në 5% (m/m). Nuk lejohet që më tepër se 20 % (m/m) të grimcave në masë e përzier të mos e plotësojnë kushtin $I_d \leq 3:1$. Aditivët organikë në masë e përzier të grimcave të gurit mund të kenë ngjyrën e 3% solucionit të alkalisë të natriumit deri në ngjyrën e verdhë të mbyllët më së shumti.

Masa e përzier e grimcave të gurit mund të përmbajë copa të shkapërderdhura ose ose të thyera deri në masën e cila u përgjigjet kërkesave të përshkruara më lart. Kapaciteti i grimcave të gurit, i determinuar në laborator sipas metodës Kaliforniane të caktimit të aftësisë bartëse të gurit, në Kaliforni (Californian bearing method (CBR), mund të jetë deri:

- për masën e përzier të grimcave natyrore dhe masën e përzier të grimcave në të cilat ka më tepër se 40% dhe më pak se 50% grimca të thyera

- për masën e përzier të grimcave të thyera dhe masat e përzier të grimcave në të cilat ka më tepër se paku 50 % dhe më pak se 80% të grimcave të thyera

Secila masë e përzier e grimcave që pritet të përdoret në BPRR duket të kontrollohet para fillimit të punëve në pajtim me kërkesat nga seksioni 3.1.1.3 i këtyre kushteve, me tri mostra. Nëse prodhimi i masës së përzier është i testuar në mënyrë të rregullt nga një institut dhe në bazë të rezultateve kualiteti i treguar i perzierjes së gurit është i përshtatshëm, atëherë një mostër duhet të kontrollohet para fillimit të punëve.

4.8.2 Metoda e ekzekutimit

4.8.2.1 Eksploatimi i masës së përzier të grimcave të gurit

Për terenin prej ku merren perzierjet e grimcave të gurit për BPRR, kontraktori duhet ta njohtoj inxhinierin mbikëqyrës në kohën e duhur para fillimit të eksplotimit. Kontraktori poashtu duhet të parashtrojë të dhënat për kualitetin e masës së përzier sipas specifikacionit nga seksioni 3.1.1.3 i këtyre kushteve teknike dhe të marrë pëlqimin prej inxhinierit mbikëqyrës. Të dhënat për kualitetin e masës së përzier të grimcave të gurit nuk duhet të jenë më të vjetra se një vit. Vendi nga merret masa e përzier e grimcave të gurit dhe gurrëthyesi duhet së pari të pastrohet.

4.8.2.2 Testet preliminare teknologjike Testet preliminare (në sipërfaqen e caktuar dhe sipas instruksioneve të inxhinierit) para fillimit të punëve duhet të demonstrojnë:

- Masën e përzier të grimcave të gurit me një ose dy mostra dhe
- Cilësitë mekanike me një ose dy mostra

të sigurojnë se cilësitë karakteristike të masës së përzier të vendosur i përgjigjen cilësive të caktuara me kontrollat preliminare të kryera para fillimit të punëve dhe të masin:

- Dendësinë e shtresës së vendosur me së paku 15 matje të dendësisë dhe përbërjes së masës së përzier të grimcave të gurit,
- Aftësia bartëse e shtresës së vendosur me së paku tri matje të modulit të deformimit
- Niveli dhe lartësia e formacionit të shtresës së vendosur me së paku pesë matje.

Para fillimit të punëve, për qdo lloj karakteristik të masës së përzier të grimcave të gurit duhet të caktohet procesi teknologjik, mjetet e përdorura për kompaktim dhe efekti i tyre global. Kështu, efekti i mjeteve të përdorura për kompaktim duhet të matet në seksionin e testimit pas qdo kalimi në së paku tri vende. Pas kompaktimit përfundimtarë të formacionit të BPRR, dendësia dhe lagështia e masës së përzier të vendosur të grimcave të gurit duhet të maten në, së paku 10 vende.

4.8.2.3 Përgatitja e formacionit të nën shtresave

Formacioni i nën shtresës duhet të përgatitet sipas specifikacioneve këtyre kushteve teknike, para fillimit të vendosjes së masës së përzier të grimcave të gurit në BPRR. Ndërtimi i BPRR mund të filloj kur inxhinieri mbikëqyrës e pranon nën shtresën të këtyre kushteve teknike. Kontraktori është i obliguar të mirëmbajë nënshtrësat në gjendjen e cila ka qenë kur është kryer pranimi i saj deri kur të filloj punimi i mbistrukturës. Të gjitha dëmet duhet të riparohen në kohë të duhur dhe evidenca e këtyre veprimeve duhet të i parashtrohet inxhinierit mbikëqyrës.

4.8.2.4 Deponimi i masës së përzier të grimcave të gurit

Nëse kontraktori deponon përkohësishtë masën e përzier të grimcave të gurit para vendosjes në BPRR, duhet së pari të përgaditet vendi i përshtatshëm.

4.8.2.5 Transporti i masës së përzier të grimcave të gurit

Masa e përzier e grimcave të gurit për BPRR mund të transportohet në nënshtrësën e përgatitur mirë vetëm pas pëlqimit të inxhinierit mbikëqyrës. Transporti në përgjithësi mund të mos kryhet mbi formacionin e përgatitur dhe të pranuar, por edhe mbi një shtresë të shtrirë të masës së përzier të grimcave të gurit. Automjetet që e bartin materialin duhet të shkarkohen duke u zbrazur anash apo nga prapa. Nëse, për arsye të shtrirjes apo vendosjes mekanike transporti i masës së përzier është pjesërishtë mbi formacionin e nënshtrësës, atëherë metoda e transportit duhet të aprovohet nga inxhinieri mbikëqyrës. Për bartjen e masës së përzier të grimcave të gurit duhet të përdoret automjeti i paisur me mekanizëm për shtrirje, mekanizimi i cili i plotëson kërkesa edhe nëse duhet të kryhet shtruarja e masës së përzier mbi formacionin e nënshtrësës. Trashësia e masës së përzier të grimcave të gurit duhet t'i përgjigjet trashësisë së kërkuar në projekt. Qdo shtresë veqmas duhet të formësohet dhe të kompaktohet para fillimit të bartjes së materialit për shtresën tjetër, nëse numri i shtresave është i paraparë.

Nëse masa e përzier e grimcave të gurit vendoset mbi shtresat e pakompaktuara, automjetet gjatë transportit duhet të jenë në mënyrë të njëjtë të shpërndara përgjatë tërë gjërësisë së masës së përzier së sjellur. Automjeteve me rrotë dhe rimorkio të papastra, me baltë, nuk iu lejohet lëvizja mbi përzierjen e sjellur ose të kompaktuar të masës së përzier të grimcave të gurit për BPRR.

4.8.2.6 Shtruarja e masës së përzier të grimcave të gurit

Shtruarja e masës së përzier të grimcave të gurit në BPRR përgjithësishtë duhet të kryhet në mënyrë mekanike. Shtruarja manuale lejohet vetëm në vendet në të cilat nuk ka qasje makina dhe kur kjo mënyrë e shtrirjes lejohet nga inxhinieri mbikëqyrës. Masa e përzier e grimcave të gurit për BPRR duhet përgjithësishtë duhet të transportohet si prodhim final në kantiër. Qfarëdo ndryshimi i përzierjes në kantiër duhet të lejohet nga inxhinieri mbikëqyrës në bazë të rezultateve të testeve preliminare. Sasia e nevojshme e ujit për të siguruar lagështi optimale për kompaktim të masës së përzier të grimcave të gurit duhet të sigurohet në vendin ku mirret masa e përzier. Nëse uji duhet t'i shtohet në vendin ku sillet atëherë kjo duhet të bëhet me stërpikje, ashtuqë të evitohet shperlarja e grimcave të imëta. Gjatë

kompaktimit përbërja e lagështisë në masën e përzier të grimcave mund të devijojë prej përbërjes optimale të lagështisë nga $\pm 2\%$ (m/m). Sigurimi i përbërjes së tillë të lagështisë është posaqërisht i rëndësishëm nëse masa e përzier e grimcave të gurit shtrohet me grejderë, ashtuqë masa e përzier mbetet sa më e njëtrajtshme që është e mundur.

Shtruarja e masës së përzier të grimcave të gurit për BPRR duhet të kryhet me makina të përshtatshme: zakonisht me finisher, me lejen e organit mbikëqyrës gjithashtu me grejder ose në raste të jashtëzakonshme me buldozer. Zakonisht, shtruarja duhet të kryhet në të njëjtën ditë kur edhe të lagurit. Masa e përzier e njëtrajtshme e grimcave të gurit, e nivelizuar sipas kërkesave nga projekti, duhet të kompaktohet me makineri të përshtatshme përgjatë tërë gjërësisë së shtresës. Për t'u arritur plotësim i kërkesave nga projekti, trashësia e shtresës së pakompaktuar duhet të rritet për 10 cm, nëse nuk është paraparë ndryshe me projekt. Shtresat duhet të kompaktohen nga shtresa e ulët kah e larta. Numri i kalimit të agensave të përshtatshëm për kompaktim, i caktuar nga testet preliminare, duhet të kontrollohet me teste rutinore të dendësisë dhe kompaktësisë të masës së përzier të vendosur të grimcave të gurit. Të gjitha parregullsitë që zbulohen gjatë kompaktimit duhet të përmirësohen në pajtim me kërkesat e inxhinierit mbikëqyrës. Të gjitha vendet në të cilat nuk ka qasje makina duhet të kompaktohen deri në nivel të kërkuar me mënyra tjera gjë që duhet të aprovohet nga inxhinieri mbikëqyrës, i cili poashtu i cakton kushtet dhe menyrat që mund të përdoren. Pas kompaktimit, poashtu edhe aftësia bartëse e konstruksionit të BPRR duhet të caktohet para kompaktimit përfundimtarë. Nëse vlerat e caktuara nga projekti nuk janë arritur, atëherë kontraktori duhet t'a sigurojë kualitetin e kërkuar të BPRR me masa të tjera..

4.8.3.1 Kualiteti i ekzekutimit

Para se të fillojnë punën makinat dhe mekanizimi prej të cilave varet kualiteti i punëve, duhet të kontrollohen mundësitë e tyre për plotësimin e këtyre kushteve teknike. Të gjitha makinat dhe mekanizimi duhet të atestohet dhe duhet t'i plotësojë kërkesat nga projekti në pikëpamje të kapacitetit.

4.8.3.2 Kompaktimi

Kompaktimi masës së përzier të grimcave të gurit në BPRR, caktohet duke e krahasuar me kompaktimit të përzierës me Metodën e modifikuar Proktor duhet të arrijë vlerën mesatare prej 98%. Kufiri i poshtëm i kompaktimit nuk duhet të jetë më i vogël se vlera mesatare për më tepër se 3%. Dendësia e masës së përzier së vendosur zakonisht duhet të caktohet përmes metodave jodestruktive të matjes me prova isotopike (dendësimet nukleare).

4.8.3.3 Aftësia bartëse

Aftësia bartëse e BPRR, caktohet me modulën e deformimit E_{v2} dhe me përqindjen e modulit të deformimit E_{v2}/E_{v1} , të caktuar me metodën Gjermane me pllakën me diametër 300mm in diameter (DIN 18134), që duhet t'u përgjigjet kërkesave të treguara në

tabelën 3.2.

Ngarkesat e trafikut

Lloji i masës së përzier të mëdha dhe shumë të mëdha të mesme ose të lehta M SM MS V

Vlerat e kërkuara

Grimcat e gurit E_{v2} E_{v2}/E_{v1} E_{v2} E_{v2}/E_{v1}

MN/m² MN/m²

- natyral $\geq 100 \leq 2.2 \geq 90 \leq 2.4$

- i thyer ose i përzier $\geq 120 \leq 2.0 \geq 100 \leq 2.2$

përqindja e modulit të deformimit E_{v2}/E_{v1} nuk është kriter kryesorë për vlerësimin e aftësisë bartëse të shtresave të masës së përzier të pastabilizuar të grimcave të gurit nëse vlera e modulit të deformimit E_{v1} është më e madhe se 60% të E_{v2} . të kërkuar të deformimit mund të jetë deri 20% më i vogël se që kërkohe në tabelën 3.2. Nëse kontraktori nuk mund ta arrij vlerën e modulit të deformimit E_{v2}/E_{v1} , inxhinieri mbikëqyrës vendos për masat që duhet të ndërmarren.

4.8.3.4 Niveli, lartësia, pjerrësia

Vrazhdësia e BPRR duhet të caktohet si devijim i rrafshuesit të gjatë 4 m e të vendosur në cilindro drejtim të aksit të rrugës. Për formacionin e BPRR lejohet vrazhdësi jo më e madhe se 20 mm (kufiri i vlerës së sipërme) Nëse devijimet e tilla përsëriten shpesh atëherë inxhinieri vendosë për metodën e përmirësimit. Lartësia e pikave të matjes në formacionin e BPRR duhet të caktohen me nivelizim. Formacioni i BPRR mund të devijojë në cilëndo pikë të zgjedhur por jo më tepër se + 10 mm ose – 15mm (vlera kufitare nga lartësia e projektuar).

Pjerrësia e formacionit të BPRR duhet të jetë e njëjtë me pjerrësinë e prerjes tërthore dhe gjatësore të trasës së rrugës. Devijimet e lejuara caktohen nga vrazhdësia e lejuar dhe devijimi nga lartësia e

formacionit të BPRR por nuk duhet të jenë më të mëdha se $\pm 0,4\%$ e vlerës absolute të pjerrësisë (vlerat ekstreme kufitare).

4.8.3.5 Kontrolli i kualitetit të ekzekutimit

4.8.3.6 Testet rutinore Inxhinieri mbikëqyrës cakton sasinë e testeve rutinore për vendosjen e masës së përzier të grimcave të gurit në BPRR në bazë të rezultateve të testeve preliminare teknologjike.

Testet minimale rutinore të masës së përzier të grimcave të gurit të cilat duhet t'i kryej kontraktori përfshijnë testet e:

- vijës granulometrike të masës së përzier të gurit në qdo 2000 m²
- rezistenca në shtypje e gurit në qdo 40000 m²
- rezistenca në thyerje e grimcave të gurit në qdo 20000 m²
- rezistenca në ngrirje e grimcave në qdo 40000 m²
- forma e grimcave në qdo 20000 m²
- përbërja e aditiveve organike në qdo 40000 m²
- aftësia bartëse e masës së përzier të grimcave të gurit në qdo 40000 m²
- përbërjen optimale të lagështisë dhe dendësinë e masës së përzier të grimcave të gurit me procesin e modifikuar të Proktoritë, në qdo 8000 m²

Testet minimale rutinore gatë vendosjes së grimcave të gurit në BPRR përfshijnë matjen e:

- matjen e lagështisë dhe dendësisë së masës së përzier në qdo 400 m²
- aftësia bartëse – moduli i deformimit në qdo 2000 m²
- niveli dhe lartësia e formacionit të shtresës në qdo 20 m¹

Në rastet kur inxhinieri mbikëqyrës konstaton në testet rutinore devijime më të mëdha të rezultateve nga testet preliminare, sasia e testeve rutinore rritet. Inxhinieri mbikëqyrës, në rastet e rezultateve të njëtrajtshme, mund të zvogëlë numrin e testeve rutinore. Kualiteti i BPRR të vendosur mund të caktohet edhe me metoda tjera afirmative nëse inxhinieri poashtu jep aprovimin. Në rastet e tilla, masat e kualitetit të masës së përzier të vendosur dhe mënyra dhe sasia e testeve duhet të caktohen në marrëveshje me inxhinierin mbikëqyrës.

4.9.1 Vendosja e skajorëve 18/24 MB40 M100,

4.9.1.1 Përshkrimi

Elementet skajor të trasës së rrugës, gurët skajorë, kufizimet dhe parmakët.

Konstruksionet e elementeve kufitare të shtresës qarkulluese të rrugës (EKS) përfshijnë:

- Furnizimin me elementet përkatëse të parafabrikuara dhe vendosjen e tyre ose
- furnizimin e të gjitha materialeve bazë të nevojshme, përpunimin e tyre dhe vendosjen në EKS, të dyjat në vendin e caktuar sipas projektit.

Kjo poashtu përfshinë tërë punën në përgatitjen e themeleve për EKS, ekzekutimin e fugave dhe mbrojtjet e nevojshme të sipërfaqes dhe poashtu punët tjera në lidhje me përforcimin e këtyre elementeve. Kjo punë duhet të kryhet në kushte klimatike pa të rreshurra atmosferike dhe pa frymë dhe me temperaturë të bazës prej 5°C deri 25°C. Nëse temperatura është kohë pas kohe më e ulët ose më e lart, atëherë duhet të ndërmerren masa të posaqme gjatë instalimit. Elementet kufitare nevoiten për mbrojtjen e skajeve të konstruksionit të rrugës dhe për rritjen e sigurisë së trafikut në të gjitha llojet e rrugëve. Lloji i elementit janë zakonisht të caktuara me projekt e nëse jo për masat e marrura vendos inxhinieri mbikëqyrës.

4.9.1.2 Materialet bazë Materialet bazë që përdoren për prodhimin e betonit dhe për konstruktimin e EKS janë të caktuara në seksionin 3.3.2 DSPN të këtyre kushteve teknike. Materialet bazë të përdorura për prodhimin e masës së përzier të betonit për prodhimin e gurëve skajorë janë të caktuara në seksionin 3.2.2.2. Gurët skajorë të betonit dhe kubëzat për kufizim duhet të jenë prej gurëve silikateve ose karbonate.

4.9.1.3 Kualiteti i materialit

Kualiteti i materialit për masat e përziera të betonit dhe të gjitha materialet e tjera për konstruktimin e EKS janë të dhëna detajisht në seksionin 3.3.3. të DSPN

Granulacioni i masës së përzier të gurit mund të devijojë nga kufijtë e caktuar gjatë prodhimit deri në 3 % (m / m). Masa e përzier e grimcave të gurit duhet të përbajë vetëm grimca të gurit të thyer. Në raste të veqanta, rëra natyrore 0/22 mm lejohet të përdoret, por vetëm në proporcion 1:1 me rërën natyrore.

Devijimet e lejuara të dimensioneve të gurëve skajorë të gurit janë:

- për gjërësi ± 3 mm,
- për lartësi ± 10 mm.

gurëve skajorë

Devijimet e lejuara të gurëve skajorë të gurit lejohet të shkojnë deri në 10 të dimensioneve të dhëna.

4.9.1.4 Testet preliminare, aprovuese

Testet preliminare duhet të kryhen para fillimit të prodhimit regularë të gurëve skajorë të parafabrikuara të betonit dhe poashtu pas qfarëdo ndryshimi të projektit të përziërjes dhe/ose procedurës teknologjike dharë prodhimit të rregullt.

Për vlerësimin e përputhshmë, janë në fuqi kërkesat nga standardet e JUS U.N2.060 përveq për ndërrimet e dhëna nga Pika 2.

Një test kryhet në gurët skajorë 28 ditë të vjetër mostër e të prerë nga pjesa e pjerrët ballore apo nga sipërfaqja e epërme e guri skajorë. Guri skajorë është adekuate nëse pas 25 ciklesh të ngrirjes dhe të shkrirjes l përgjigjet kriterit 1 nga JUS U.M1.055 (humbja e masës < 0.200 mg/mm², thellësia e dëmtuar < 1mm).

Testi kryhet në 3 (tre) mostra dhe sipërfaqja e mostrës individuale nuk duhet të jetë më e vogël se 100 cm².

4.9.1.5 Kontrolli i prodhimit rutinorë

Të gjitha parametrat e parapara në fuqi, përveq:

- Rezistencës në tërheqje të gurit skajorë të betonit nuk është e testuar,
- Rezistenca në abrazion nuk është e testuar,
- Rezistenca në ngrirje është e kontrolluar është e kontrolluar duke marrur mostra si pjesë e e kontrollave regullare të kualitetit në uzinë,
- Rezistenca në përmbajtjes së krypërave për shkrirje kontrollohet në mostrat e marrura në vend për kubëza.

Një test kryhet në kubëzën 28 ditë të vjetër mostër e të prerë nga pjesa e pjerrët ballore apo nga sipërfaqja e epërme e gurit skajorë. Guri skajorë është e përshtatshme nëse pas 25 ciklesh të ngrirjes dhe shkrirjes plotësohen këto kriterë:

- Humbja në masë nuk është më e madhe se 0.250 mg/mm²,
- Thellësia e dëmtuar nuk është më e madhe se 2.0 mm.

Nëse humbja në masë pas 25 ciklesh është më e madhe se 0.250 mg/mm² por më e vogël se 0.350 mg/mm² procedura duhet të vazhdohet deri në 50 cikle. Nëse humbja e tërësishme pas 50 ciklesh të ngrirjes shkrirjes në prezencën e krypës nuk l tejkalon 0.500 mg/mm² dhe dëmtimet në thellësi nuk l tejkalojnë 2,5 mm, guri skajorë kubëza konsiderohet si e rezistueshme ndaj ngrijës.

Gjatë testimit mostra duhet të jetë e mbështjellur me folie plastke për ta penguar avullimin dhe për ta mbajtur koncentrimin e njëtrajtshëm të solucionit të krypës.

4.9.1.6 Metoda e ekzekutimit - Pregatitja e bazës

Baza për gjërësi shtesë nga betoni mund të jenë:

- formacioni i bazës së pastabilizuar të rrugës,
- formacioni i nën-bazës së stabilizuar

Kontraktori mund të fillojë konstruktimin e EKS kur inxhinieri mbikëqyrës ka kryer pranimin e bazës sipas kërkesave të caktuara. Kontraktori është i detyruar të mirëmbajë formacionin e bazës në gjendjen në të cilën ka qenë pas pranimit e deri tek fillimi i vendosjes së EKS. Të gjitha dëmet duhet të jenë në kohë të duhur të riparuar dhe për këto riparime duhet që inxhinierit mbikëqyrës t'i sigurohen të dhënat komplete.

4.9.1.7 Vendosja e gureve skajor

Guri skajorë dhe kufizimet e parafabrikuara duhet të vendosen zakonishtë në fundamentin e formuar nga betoni i freskët (MB 15) sipas projektit.

Trashësia e shtresës mbështetëse duhet të jetë:

- nën gurin skajorë së paku 15 cm dhe

Distanca mes gurëve skajorë duhet të jetë 10 deri 15 mm. Këto fuga duhet të plotësohen me llaq të qimentos në ballë dhe në anën e epërme deri në thellësinë jo më të vogël se 30 mm, fugat e mbetura duhet të mbushen me rërë adekuate. Sipërfaqja e fugës nga llaqi i qimentos duhet të jetë i profiluar në mënyrë adekuate. Në rsate të veqanta , kubëzat dhe kufizimet duhet poashtu të jenë të vendosura edhe në shtresën bazë të pastabilizuar. Kjo varet nga inxhinieri mbikëqyrës.

4.9.1.8 Mbrojtja e betonit

Mbrojtja e nevojshme e betonit gjatë pregatitjes së elementeve të parafabrikuar dhe vendosja në SPS është e përshkruar në seksionin 3.3.4.7 të DSPN.

Kushtet për kualitetin e betonit SPS janë të dhëna në detale në seksionin 3.3.5. Pos këtyre kërkesave, duhet të merret parasysh edhe një, ajo e shtresës së mbrojtjes së hekurit për armirimin e barierës mbrojtëse duhet të jetë së paku 4 cm. Nëse kërkesat për kualitetin e betonit për EKS të veqantë nuk janë të caktuara me projekt, atëherë inxhinieri mbikëqyrës i cakton ato në bazë të punëve të ngjajshme të treguara në këto kushte teknike. 4.9.1.9 Testet rutinore

Numri i testeve rutinore gjatë konstruktimit të EKS caktohet nga inxhinieri mbikëqyrës sipas rezultateve të testeve teknologjike preliminare

Numri minimal i testeve rutinore të cilat kontraktori duhet t'i ekzekutojë përfshijnë:

- Për gjërësi shtesë sipas numrit adekuat, të gjitha testet të cekura në seksionin 3.3.6.1
- Për gurë dhe për gurë skajorë parafabrikuar dhe kubëza për kufizime të gjitha testet e dhëna në seksionin 3.4.6.1 in me proporcion $400 m_2 = 100 m_1$,
- Për barrierat mbrojtëse të gjitha testet përkatëse nga seksioni 3.3.6.1 me koeficient $4000 m_2 = 100 m_1$.

Në rastet kur inxhinieri mbikëqyrës zbulon devijime të mëdha të rezultateve rutinore nga ato preliminare teknologjike, inxhinieri mbikëqyrës mundet me i rritë sasinë minimale të testeve rutinore. Në rastet e rezultateve të njëtrajtshme, inxhinieri mbikëqyrës poashtu mund t'a zvoglojë sasinë e testeve rutinore. Kualiteti i KUBEZAS të vendosur mund të caktohet edhe me metoda tjera të njohura, me pëlqimin e inxhinierit mbikëqyrës. Në raste të tilla, masat për caktimin e kualiteti të vendosjes dhe metodat dhe numri i testeve duhet të caktohet në marrëveshje me inxhinierin mbikëqyrës

4.9.1.10 Testet kontrolluese

Sasia e testeve kontrolluese të cilat kontraktori duhet t'i kryej është zakonishtë në proporcion prej 1:4 me testet rutinore. Vendi i marrjes së mostrave të masës së përzier bituminoze dhe vendet për kryerjen e matjeve të kualitetit, matjejt kontrolluese dhe rutinore të EKS janë të determinuara nga inxhinieri mbikëqyrës me metodën statistikore të selekcionimit të rastësishëm.

4.9.1.11 Matja e punëve dhe Pranimi i puneve

Puna e kryer matet sipas seksionit 4.1. të KPT dhe llogaritet ne metra gjatesi. Te gjitha sasitë janë të matura sipas gjendjes aktuale dhe sipas llojit të punëve sipas paramasës nga projekti.

Skajoret e vendosur pranohen nga inxhinieri mbikëqyrës sipas kërkesave për kualitet të këtyre kushteve teknike dhe sipas seksionit 4.2 të KPT. Të gjitha mangësitë e zbuluara sipas këtyre kërkesave duhet të korigjohen nga kontraktori para vazhdimit të punëve, përndryshe aplikohenzbritjet (deduksionet) për shkak të kualitetit joadekuat. Të gjitha shpenzimet për korigjimin e mangësive i heq kontraktori duke përfshirë edhe shpenzimet e e matjeve dhe të testeve që kanë treguar kualitetin joadekuat të punëve edhe njëherë pas korigjimit të kryer. Për tërë punën e cila nuk i përgjigjet kualitetit të kërkuar sipas këtyre kushteve teknike (kur ato i tejkalojnë vlerat kufitare apo vlerat ekstreme kufitare) dhe kontraktori nuk i ka korigjuar sipas instruksioneve të inxhinierit mbikëqyrës, ai nuk mund ta justifikojë asnjë kërkesë për pagesë. Punëdhënësi në këto raste mund të kërkojë zgjatjen e garancionit për të gjitha punët gjë që varet nga punët e pariparuara për së paku pesë vite.

Furnizimi dhe punimi i shtresave bituminoze

4.10.1 Përshkrim

